

RAPORT
“AKTIVITETI I SHOQËRISË KESH SH.A. PËR VITIN 2024”

Shkurt 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

AKRONIME	3
1. SITUATA NË TË CILËN SHOQËRIA USHTROI VEPRIMTARINË E SAJ PËR 2024	4
1.1 SITUATA DHE ZHVILLIMET NË SEKTORIN ELEKTROENERGJITIK	4
1.2 SITUATA E TREGJEVE TË ENERGJISË DHE DIVERSIFIKIMI	5
2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT GJATË 2024	7
2.1 MASAT PËR GARANTIMIN E FURNIZMIT ME ENERGJI NË FUNKSION TË DSHP	7
2.2 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2024.....	8
2.3 PËRMBLEDHJE E SITUATËS HIDRIKE.....	11
2.4 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK.....	13
2.5 KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM I AKTIVITETIT	15
3. ZHVILLIME LIGJORE/RREGULLATORE TË LIDHURA ME AKTIVITETIN 2024	17
3.1 ZHVILLIME LIGJORE	17
3.2 ZHVILLIME RREGULLATORE	18
4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM	21
4.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE – OPERIMI.....	21
4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE	27
4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE	28
4.4 CILËSIA E PRODHIMIT	31
5. BILANCI ENERGJETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2024	32
5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGJETIK	32
5.2 AKTIVITETI NË PLOTËSIMIN E DSHP	34
5.3 AKTIVITETE TREGTARE TË TJERA.....	37
6. AKTIVITETI INVESTUES 2024	41
6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE.....	41
6.2 INVESTIMET E ME FONDET E HUAJA	44
6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA.....	45
6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRE.....	46
7. AKTIVITETI EKONOMIKO-FINANCIAR PËR VITIN 2024	47
7.1 AKTIVITETI I OPERACIONEVE TË VIJUESHËM	47
7.2 MARRËDHËNIET BRENDA SEKTORIT ELEKTROENERGJETIK	51
8. KONKLUZIONE	55

AKRONIME

APA	- Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të KESH sh.a.
ALPEX	- Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
BB	- Banka Botërore
BERZH	- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	- Burimet e Rinovueshme të Energjisë
CROPEX	- Bursa Kroate e Energjisë
DAM	- Tregu i Ditës në Avancë (Day Ahead Market)
DSHP	- Detyrimi për Shërbim Publik
EIP	- Plani i Investimeve Ekonomike të Bashkimit Europian në Ballkanin Perëndimor
ERE	- Enti Rregullator i Energjisë
FMF	- Furnizuesi i Mundësisë së Fundit
FTL	- Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.
FSHU	- Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.
HUPX	- Bursa Hungareze e Energjisë
HUDEX	- Bursa Hungareze e Derivateve të Energjisë
IDM	- Tregu brenda Ditës (IntraDay Market)
IEA	- International Energy Agency
IRENA	- International Renewable Energy Agency
KESH	- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., ose në vijim Korporata/Shoqëria
KfW	- Banka Gjermane e Zhvillimit
KOSTT	- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
MF	- Ministria e Financave
MIE	- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NEMO	- Nominated Electricity Market Operator (Bursa e Energjisë)
OST	- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike sh.a.
OSHEE Grup	- Grupi Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
OSSH	- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
PEF	- Programi Ekonomiko-Financiar i KESH sh.a.
PPE	- Prodhuesit me Përparësi të Energjisë
REMIT	- Rregullore për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë
SEECAO	- Zyra e Koordinimit të Ankandëve të Kapaciteteve për Europën Juglindore
ViD	- Vau i Dejës
WBIF	- Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor

1. SITUATA NË TË CILËN SHOQËRIA USHTROI VEPRIMTARINË E SAJ PËR 2024

1.1 SITUATA DHE ZHVILLIMET NË SEKTORIN ELEKTROENERGJITIK

Viti 2024 u karakterizua si një vit aktiviteti intensiv për Korporatën, por edhe për zhvillimet e sektorit elektroatenergjetik në tërësi. Gjatë 2024, veprimtaria e KESH sh.a., u zhvillua në kushte normale, pasi gjendja e emergjencës së furnizimit me energji elektrike, e cila me VKM nr. 449; dt. 26.07.2023 e zgjati afatin e saj deri në 31 Dhjetor 2023, u shfuqizua. Kjo, krijoi premisa që Korporata të ishte më e orientuar nga tregu, duke rimarrë pozicionin e saj më natyral dhe të ushtrojë aktivitetin në kushte normale, në tregun/sektorin e energjisë elektike.

Gjithsesi, për vetë statusin si kompania e vetme publike e prodhimit dhe njëkohësisht prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në vend, veprimtaria bazë e saj mbetet përmbushja e objektivit për furnizim me energji elektrike në kuadër të detyrimit për shërbim publik të konsumatorëve universal. Pra aktiviteti kryesor mbetet veprimtaria në tregun e rregulluar të energjisë.

Ndërkohë sektori elektroatenergjetik dhe veçanërisht tregu i energjisë elektrike, gjatë vitit 2024 ka njohur zhvillime të konsiderueshme, në kuadër të reformave transformuese drejt de-rregullimit, dhe afrimit drejt standarteve të vendosura nga Komuniteti Europian të Energjisë, me objektiv rritjen e konkurrencës dhe transparencës në tregun e energjisë. Në lidhje me evoluimin e panoramës së tregut të energjisë elektrike 2024, veçojmë si zhvillimet më të rëndësishme:

- Nga 1 Shkurt 2024, tregjet e energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës u bashkuan në ALPEX. Kjo do të thotë që nëpërmjet Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (ALPEX), edhe Kosova do të kryejë aktivitetin e shit-blerjes së energjisë për profilin e tregtimit DAM nëpërmjet kësaj burse. Ky është hapi final i unifikimit të tregut të energjisë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Tashmë me hyrjen e tregut të Kosovës në bursë, roli i APEX si NEMO (Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike) ridimensionohet në nivel rajonal, dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për zhvillimin e sektorit elektroatenergjetik.
- Një zhvillim tjetër mjaft i rëndësishëm, është edhe dalja në treg të lirë e konsumatorëve të lidhur në nivel tensioni 20 kV prej 1 Janar 2024. Ky hap i rëndësishëm drejt liberalizimit të sektorit, ka impakt pozitiv edhe në aktivitetin komercial të Korporatës, pasi dalja e këtij segmenti lehtëson KESH nga një pjesë furnizimi për DSHP (detyrimi për shërbim publik). Në këto kushte, KESH ka potencialisht në dispozicion më shumë sasi të lirë energjie për tregtim, duke u fokusuar në kapjen e sinjaleve të tregut për çmime atraktive, me objektiv maksimizimin e të ardhurave të Shoqërisë. Për më tepër, liberalizimi i tregut për fashën e tensionit 20 kV, krijon oportunitet biznesi për KESH, pasi duke shfrytëzuar licencën për furnizimin me pakicë, Korporata mund furnizojë klientë që kanë dalë në treg të lirë nga ky segment konsumatorësh energjie elektrike.
- Gjithashtu nga 12 Dhjetor 2024, pas plotësimit të kushteve proceduriale/rregullatore dhe testimeve teknike me sukses, ALPEX çeli live edhe aktivitetin e shit-blerjes së energjisë për profilin e tregtimit IDM (Intra-Day Market). Ky hap mjaft i rëndësishëm ridimensionon modelin shqiptar të tregut të energjisë, në nivele dhe standarte operimi nga më bashkëkohorët, duke integruar më ngushtë tregun e organizuar të energjisë nga ALPEX me tregun europian të energjisë.
- Ecuria e pozitive e reformave në sektor drejt liberalizimit, dhe implementimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë drejt standarteve bashkëkohore dhe integruese, përveç rritjes së konkurrencës dhe transparencës brenda sektorit, në fund të fundit janë mjete për arritjen e një objektivit madhor, ofrimin e shërbimit sa më cilësor të furnizimit me energji elektrike dhe pse jo me kosto sa më të lirë për konsumatorin final. Në këtë optikë, që në gjysmën e dytë të vitit 2024, Qeveria Shqiptare, lançoi iniciativën për rishikimin e çmimit të energjisë për klientët universalë të fashës "Familjarë". Pas analizave ekonomike në bashkëpunim me operatorët e sistemit, veçanërisht OSHEE/FSHU dhe KESH, duke vlerësuar përmirësimin e situatës financiare, veçanërisht të FSHU dhe perspektivën pozitive për 2025, u propozua ulja e çmimit për konsumatorët "Familjarë" nga 9.5 ALL/kWh (pa TVSH), në 8.5 ALL/kWh (pa TVSH), për konsumin mujor deri në 700 kWh. Ndërsa për konsumin mujor mbi 700 kWh, çmimi të mbetet i pandryshuar, pra 9.5 ALL/kWh (pa TVSH). Propozimi u miratua nga ERE me vendimin nr. 10, dt. 08.01.2025, dhe hyri në fuqi nga 01 Shkurt 2025.

Ky vendim ka impakt pozitiv të prekshëm në financat e familjeve shqiptare, por gjithashtu vendosja e limitit të konsumit deri në 700 kWh, nxit sjelljen konsumatore drejt përdorimit me efikasitet dhe përgjegjshmëri kursimi në konsumin e energjisë elektrike.


Në këtë vendim promovues për konsumatorët, kontribut thelbësor ka edhe KESH sh.a., jo vetëm si furnizuesi me sasi të energjisë elektrike i FSHU-së, për këtë kategori konsumatorësh, por duke kontribuar direkt në marzhin e uljes së çmimit, pasi tashmë KESH do t'ja shesë FSHU energjinë për DSHP, me çmim më të ulët nga 2.6 ALL/kWh (pa TVSH), në 2.34 ALL/kWh (pa TVSH).

1.2 SITUATA E TREGJEVE TË ENERGJISË DHE DIVERSIFIKIMI

Përshkallëzimi i konfliktit në Lindjen e Mesme dhe lufta në vazhdim e Rusisë në Ukrainë nënvizojnë rreziqet e vazhdueshme të sigurisë së energjisë me të cilat përballlet bota. Disa nga efektet e menjëhershme të krizës globale të energjisë kishin filluar të zvogëloheshin në vitin 2023, por rreziku i ndërprerjeve të mëtejshme tani është shumë i lartë. Përvoja e viteve të fundit tregon se sa shpejt varësitë mund të kthehen në dobësi. Veçanërisht kjo e vërtetë vlen për Evropën, e cila krijoi varësi të lartë ndaj gazit rus, duke sjellë pasoja të papritura në zinxhirët e furnizimit. Pra sfida që përballojnë sot tregjet e energjisë është brishtësia në sigurinë e energjisë. Fragmentarizimi dhe përqendrimi i furnizimeve me karburante si naftë dhe gaz, në zona si Lindja e Mesme dhe Rusi-Ukrainë, si pasojë e paqëndrueshmërisë gjeopolitike, sjellin rrisje potenciale të larta për ndërprerje të befta afat-shkurtra të këtyre furnizimeve. Mjafton të përmendim që gati 25% e furnizimeve botërore të naftës dhe LNG, kalojnë nëpër ngushticën e Hormuzit (Lindje e Mesme), për të kuptuar nivelin e lartë të riskut në furnizim, duke rritur ndjeshëm pasigurinë energjitike dhe rrjedhimisht paqëndrueshmëri të tregjeve të energjisë, veçanërisht në Evropë.

Më poshtë, paraqitet grafikisht kurba e çmimit mesatar mujor të energjisë për profilin Base Load (BL) dhe Peak Load (PL), sipas Bursës Hungareze (HUPX) në mbyllje pozicioni (ATC-At The Close Order).


Grafiku 1. Çmimi mesatar mujor 2024 BL vs PL në HUPX (Eur/MWh)



Grafiku i mësipëm tregon pikërisht këtë luhajtje të kuotimeve, me amplituda të forta dhe frekuenca afat-shkurtra, ku në gjysmën I të 2024, vërehet tendenca ulëse e nisur në fundin e 2023. Por, pas muajit Maj vihet re trend rritje të çmimeve, shoqëruar me luhajtje të konsiderueshme. Pra në ndryshim me vitin 2023 ku në profilin BL diferenca ndërmjet çmimit maksimal (148.69 Eur/MWh) dhe çmimit minimal (81.72 Eur/MWh) ishte 63 Eur/MWh, ky ndryshim në 2024 për të njëjtin profil BL është rritur në gati 102

Eur/MWh (163.72 Eur/MWh - 61.96 Eur/MWh). Pikërisht kjo sjellje mjaft sensitive e tregut, lidhet me paqëndrueshmërinë në sigurinë energjitike, nga risku i lartë që mbart zinxhiri i furnizimit. Përsa i përket të ardhmes afatshkurtër, referuar të dhënave të HUDEX mbi kontratat derivative të së ardhmes, aktualisht parashikohet që indeksi BL për 6-M I 2025 të jetë rreth mesatares 110 Eur/MWh. Ndërkohë, për vitin 2026 indeksi BL parashikohet të kuotohet në rreth 105 Eur/MWh. Gjithsesi, edhe këto projeksione për shkak të pasigurisë së lartë afat-shkurtër, merren me mjaft rezervë. Ajo që parashikohet me një shkallë sigurie, është se çmimet do të vazhdojnë të jenë relativisht të larta dhe mjaft të varura nga situatat gjeopolitike në rajonet e sipërpërmendura.

Grafiku 2. Kapacitete Totale Globale të Instaluar BRE (GW)



* Vlera për vitin 2024 është paraprake

Referuar IRENA dhe IEA dhe grafikut të mësipërm, në rang global, totali kapaciteteve të instaluar BRE nga 1.83 TW në 2014, parashikohet sipas vlerësimeve paraprake të ketë arritur në fund të 2024 në 4.53 TW, me rritje gati 2.5x. Vërehet që rritja/shtesa më e madhe vjetore në kapacitete BRE, është ajo e vitit 2024, me vlerë paraprake +666 GW (+17%). Për më tepër, nga kjo shtesë prej 666 GW në 2024, rreth 75% të saj e përbëjnë kapacitetet BRE të teknologjisë PV/Solar.

Parashikimet janë që shtesat e kapaciteteve të BRE të rriten vit pas viti, duke projektuar që në vitin 2030 shtesa vjetore në kapacitete BRE të arrij gati 935 GW. Gjithsesi, me këtë ecuri bazuar në projeksionet e IRENA dhe IEA, sipas Skenarit Kryesor (Main Scenario), në fund të 2030 kapaciteti global kumulativ i instaluar i BRE të arrijë 9,763 GW, duke mos arritur objektivin e vendosur në samitin e klimës COP28, për 3-fishimin e kapaciteteve globale BRE deri në fund të 2030 në 11,000 GW të instaluar. Kjo kërkon ritëm dhe përpjekje më të mëdha nga 145 shtetet e angazhuara, për të kapur targetin sipas “Skenarit të Përsheptuar (Acceleratd Scenario), prej 10,800 GW ≈ 11,000 GW, deri në fund të 2030.

Sipas parashikimeve, epoka 2024-2030 e diversifikimit global, do të ketë dy fjalë kyçe “PV/Solar” dhe “Kina”, për arsyet e mëposhtme:

- “PV/Solar”, përcaktohet si teknologjia mbizotëruese për kapacitetet shtesë BRE. Deri në fund të 2030, teknologjia PV/Solar do të përbëjë rreth 80% të kapaciteteve shtesë BRE, duke e kthyer atë në alternativën kryesore të diversifikimit global.
- “Kina”, është aktualisht vendi kryesues dhe do të thellojë dominimin, me diferencë të ndjeshme në shtimin e kapaciteteve të reja BRE. Parashikohet që në fundin e 2030, Kina të zotërojë rreth 48% të kapacitetit global të instaluar BRE, duke lënë pas BE me 13%, SHBA me 9% dhe Indinë me 6%. Ky pozicion dominues i Kinës në kapacitete dhe rrjedhimisht edhe në prodhimin e energjisë nga BRE, shqetëson analistët e tregjeve të energjisë. Për ta, ky përqëndrim i lartë i BRE te Kina, po sjell fragmentarizim të burimeve BRE dhe në të ardhmen mund të krijoj varësi nga Kina, duke mbartur riskun se në rastin e ndonjë anomalie të zinxhirit të furnizimit me energji të prodhuara nga BRE nga Kina, mund të çënojë sigurinë energjitike në rajonet e tjera të globit dhe paqëndrueshmëri/kriza në tregjet e energjisë. Sipas ekspertëve të energjisë, kjo do të ishte një “deja-vu”, e ngjashme me situatën aktuale (që përmendëm më lart), që po kalojnë sot tregjet e energjisë, veçanërisht ato europiane nga karburantet fosile. Por, nëse burimet fosile janë të përcaktuara nga natyra, ato BRE ndërtohen nga njeriu, kështu që rajonet e tjera të globit duhet të mendojnë dhe të veprojnë me shpejtësi për ta zbutur këtë disbalancë.

2. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT GJATË 2024

Referuar sfondit të përgjithshëm të përgjithshëm global dhe atij kombëtar të përshkruar në paragrafin e mëparshëm, ndër zhvillimet kryesore, të cilat shenjua performancën e aktivitetit operacional-ekonomik të Korporatës gjatë 2024, mund të renditim në vijim:

2.1 MASAT PËR GARANTIMIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI NË FUNKSION TË DSHP

Pavarësisht, shfuqizimit të gjendjes së emergjencës në sektor, duke filluar nga 1 Janari 2024, përsëri pozicioni i Korporatës në tregun e energjisë është specifik, duke pasur si aktivitet parësor, atë në tregun e rregulluar të energjisë. Për këtë arsye, në cilësinë e ushtruesit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, KESH si kompani publike dhe prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në vend, është ngarkuar me detyrimin për shërbim publik në kuptim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Edhe gjatë 2024, ky furnizim është realizuar në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022 dhe nr. 449, datë 26.07.2023, i cili përcakton kushte për implementimin e detyrimit të shërbimit publik për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike. Pra, në aspektin tregtar dhe atë të biznesit, aktiviteti i Korporatës vazhdoi të ushtrohej mbi objektivin prioritar për furnizim, në funksion të plotësimit të DSHP-së.

Në volum, për furnizimin e FSHU-së në funksion të DSHP-së për vitin 2024 u planifikua sasia rreth 5.3 TWh. Krahasuar me vitin 2023 ku plani ishte rreth 5.7 TWh, ky parashikim ishte më i ulët me -0.4 TWh. Kjo vjen si efekt i ecurisë së liberalizimit të tregut, ku nga 01 Janar 2024, konsumatorët e lidhur me nivelin e tensionit 20 kV, dolën në furnizim në tregun e lirë. Kjo ulje e DSHP-së ndihmon Korporatën për të pasur potencialisht volume më të lira energjie për tregtim në tregun e lirë. Sasia e planifikuar do të sigurohej 4 TWh nga prodhimi i KESH dhe 1.3 TWh nga kombinimi Blerje+Teprica Depozitime të FTL. Për vitin 2024, KESH sh.a. ka furnizuar shoqërinë FSHU/FMF për klientët universal në funksion të përmbushjes së DSHP, për gjithë sasinë e nevojshme prej mbi 5.6 TWh (5,609,214 MWh). Kjo sasi është -2.4% më e ulët se sasia prej 5.75 TWh, lëvruar për DSHP në vitin 2023.

Gjatë vitit 2024, në funksion të përmbushjes së DSHP, 73% e kërkesës së klientëve universal u garantua nga prodhimi i brendshëm/rezerva energjitike e kaskadës së Drinit, 15% nga blerja e energjisë në tregun e lirë dhe 12% marrje energji elektrike nga HEC-et e vegjël e me koncension (për atë sasi energjia elektrike që tepron mbas mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes).

Referuar kushteve hidrike dhe situatës së tregjeve, edhe gjatë 2024, Shoqëria u angazhua maksimalisht, në shfrytëzimin e mekanizmave, në funksion të përmbushjes së DSHP-së. Përveç prodhimit të brendshëm, Korporata shfrytëzoi mekanizmat si më poshtë:

- Gjatë 2024, KESH siguroi energji në sasinë prej 258,383 MWh nga impianti PV Karavasta Solar, në kushtet e PPA (Power Purchase Agreement);
- Gjatë 2024, gjeneruesit termik kontribuan me 22,640 MWh, si pjesë e garantimit për siguri në prodhim të KESH;
- Shfrytëzimi i mekanizmit të tepricave (pas mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes) të depozituara nga PVPE, për llogari të FTL, të cilat KESH i shfrytëzon për furnizim të FSHU;
- Shkëmbimit marrje/dhënie të energjisë, veçanërisht me KEK, duke siguruar rezervë energjetike reciproke në periudhat e nevojshme ndërmjet palëve. Konkretisht gjatë 2024, KESH mori nga KEK sasinë prej 64,465 MWh;
- Optimizimi i kostove në proceset e blerjes së energjisë duke ndjekur sinjalet e tregjeve të energjisë, konkretisht të bursës HUDEX, e cila jep një parashikim të çmimeve për javën, muajin dhe vitin në avancë.
- Masa efektive mbi programimin dhe operim racional/efiçent dhe nën monitorim të kujdesshëm për të maksimalizuar prodhimin, por duke administruar në ekuilibër optimal variablat Prurje-Nivel-Rezervë Energjetike, duke kontribuar në maksimizimin e prodhimit;
- Shitje sa më efektive në kushtet e periudhave me prurje të mëdha, bazuar në rregulloren e tregtimit.
- Optimizimi ekonomik afat-shkurtër, sipas sinjaleve të çmimeve të tregut dhe bazuar në rregulloren e tregtimit, për të siguruar të ardhura shtesë.

2.2 PROGRAMI EKONOMIKO-FINANCIAR I KESH SH.A. PËR VITIN 2024

Gjatë vitit 2024, KESH sh.a. e zhvilloi aktivitetin, bazuar në PEF 2024 (2025-2028), të miratuar me vendimin e KMb të KESH sh.a. Nr. nr. 3; datë 26.01.2024 “Për miratimin e Programit Ekonomiko-Financiar të Shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2024 dhe parashikimi për 2025-2028”, miratuar përfundimisht me vendimin e APA Nr. 936/1, datë 14.02.2024.

Nga pikpamja hidrike 6-mujori i parë i vitit 2024 ka qenë një periudhë disi e thatë, me reshje dhe prurje që kanë rezultuar nën vlerat mesatare shumëvjeçare përkatëse. Rritja e rezervës energjetike gjatë 6-mujorit të parë erdhi si rrjedhojë e rritjes së sasive të energjisë marrë nga prodhimi i impiantit fotovoltaiik Karavasta Solar si dhe nga energjia e depozituar nga FTL sh.a., në kuadër të rrëzimit të midis palëve për administrimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Duke filluar nga muaji Qershor 2024, temperaturat kapen vlera mbi mesataren e sezonit çka solli edhe rritje të konsumit të energjisë elektrike nga FSHU e rrjedhimisht edhe rritje të prodhimit me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik.

Në vijim përse më sipër, ndryshimi i situatës hidrike nga parashikimi, solli nevojën për rikalibrim të objektivave operativ të Korporatës për periudhën e mbetur të vitit, duke e bërë të domosdoshme rishikimin e Programit Ekonomiko - Financiar (PEF) për vitin 2024 dhe në vijim për vitet 2025-2028.

Në këtë kuadër, PEF 2024 (2025-2028) u rishikua, me vendimin Nr. 13; datë 30.07.2024, të KMb "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në Programin Ekonomiko-Financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2024", miratuar përfundimisht me vendimin e APA Nr. 6503/1; datë 08.08.2024.

Po kështu, PEF 2024 (2025-2028) u rishikua përsëri, me vendimin Nr. 17; datë 30.09.2024, të KMb "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në Programin Ekonomiko-Financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2024", miratuar përfundimisht me vendimin e APA Nr. 6503/3; datë 28.10.2024.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse të volumeve të energjisë/bilanci energjetik dhe krahasimi ndërmjet Planit të Miratuar 2024 dhe Planit të Rishikuar II 2024:

Tabela 1. Bilanci Energjitik Plani i Rishikuar 2024 vs Plani i Miratuar 2024 (MWh)

Treguesit - Plani BE 2024 KESH sh.a. (në MWh)	Viti 2024 (PEF i Miratuar)	Viti 2024 (PEF i Rishikuar I)	Viti 2024 (PEF i Rishikuar II)	Variance BE (PEF Rish. II vs PEF i Miratuar)	Variance BE në % (PEF Rish. II vs PEF i Miratuar)
Prodhimi Neto KESH	4,734,214	4,055,262	4,061,468	(672,746)	-14.2%
Energji nga Karavasta Solar T1 & T2 (PPA)	232,259	295,653	303,821	71,562	30.8%
Shkëmbimi KESH / marrje	0	154,794	62,794	62,794	100.0%
Blerje energjie me çmime tregu (import + tregtarë vendas, VKM 456/2022)	462,131	748,094	821,121	358,990	77.7%
Blerje energjie për optimizim (import + tregtarë vendas)	0	126,350	46,450	46,450	100.0%
Marrje depozitim nga FTL	0	556,145	556,151	556,151	100.0%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	168,000	198,105	196,043	28,043	16.7%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	0	14,136	13,221	13,221	100.0%
Blerje Alpex (nga tregtarë të regjistruar në Bursë)	0	56,177	54,270	54,270	100.0%
Disbalanca negative KESH	14,400	30,170	31,189	16,789	116.6%
ASHTA Devijim pozitiv	0	3,363	3,363	3,363	100.0%
Total energji për tregtim nga KESH + shkëmbim	5,611,004	6,238,249	6,149,891	538,887	9.6%
Shitje FSHU/OSHEE - klientë tariforë (0.4 kV)	4,445,888	4,484,926	4,449,967	4,079	0.1%
Shitje FMF - klientë tariforë (6/10/20/kV)	619,093	0	0	-619,093	-100.0%
Shitje FMF - klientë tariforë / Alpex (6/10/20/kV)	0	382,937	390,897	390,897	100.0%
Shitje FSHU/OSHEE - klientë tariforë UK	185,361	152,709	162,163	-23,198	-12.5%
Shitje FSHU nga energjia e depozituar FTL	0	556,145	556,151	556,151	100.0%
Shitje OST humbje / Alpex	216,000	0	0	-216,000	-100.0%
Shitje Alpex (Tregtar i regjistruar në Bursë)	0	63,784	51,787	51,787	100.0%
Furnizim për nevojat vetjake (Karavasta Solar+Renco)	0	2,598	2,618	2,618	100.0%
Kthim borxhi shoqërisë FTL, VKM 456/2022	0	207,000	232,119	232,119	100.0%
Shkëmbimi KESH / dhënie	0	6,320	6,320	6,320	100.0%
Shitje me çmime tregu (eksport + tregtarë vendas)	36,662	79,569	79,569	42,907	117.0%
Shitje energjie për optimizim (eksport + tregtarë vendas)	0	126,290	46,690	46,690	100.0%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	84,000	79,436	80,180	-3,820	-4.5%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	0	17,653	16,797	16,797	100.0%
Disbalanca pozitive KESH	24,000	77,242	71,702	47,702	198.8%
ASHTA Devijim negativ	0	1,639	2,929	2,929	100.0%
Total energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim	5,611,004	6,238,249	6,149,891	538,887	9.6%
Disbalanca energjie për t'u verifikuar nga Operatori i Tregut (OST)	-0	0	-0	-0	0%

Në total volumet e energjisë të Planit të Rishikuar II parashikohen më të larta +538,887 MWh (+9.6%), krahasuar me Planin e Miratuar. Sipas rubrikave, zërat e rishikuar më të spikatur, konsistojnë në:

- **Rubrika - Energji për tregtim nga KESH + shkëmbim marrje:**
 - Prodhimi i brendshëm neto u rishikua në 4,061,468 MWh, ose -672,746 MWh/-14.2% më pak;
 - Importi/Blerje për plotësim DSHP u rishikua në 821,121 MWh, ose +358,990 MWh/+77.7%;
 - Marrje depozitim nga FTL u rishikuan me 556,151 MWh, ose +100% nga PEF original;
 - Po kështu u rishikuan rritje në energji nga Karavasta Solar, blerje energji balancuese etj.
- **Rubrika – Energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim dhënie:**
 - Shitje OSHEE klientë tarifor FSHU/FMF, në funksion të përmbushjes së DSHP rishikua në 5,559,179 MWh, ose +308,837/+6% nga plani fillestar;
 - Kthim Borxhi FTL, për depozitimet në KESH në 232,119 MWh,+100%, nga PEF original MWh;
 - Po kështu, rishikohen me rritje Shitje energjie, optimizimi dhe në ALPEX, pra në tregun e lirë Pra në tërësi, Bilanci Energjitik, si efekt i situatës hidrike jo të favorshme, në funksion të përmbushjes të DSHP, u rishikua me ulje të prodhimit të brendshëm, e cila kompensohet kryesisht me rritje të importeve/blerjeve dhe nga depozitimet e FTL për shitje ndaj FSHU.

Rikonfigurimi i aktivitetit energjitik, si aktiviteti kryesor, reflektoi rishikimin e PEF, ku planifikimi i operacioneve të vijueshme të aktivitetit, përmbledhen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2. PL/PEF i Miratuar 2024 vs PL/PEF i Rishikuar 2024

P & L Operacional 2024 (Shumat janë të shprehura në mijë lekë)	PL_PEF 2024 (i Miratuar)	PL_PEF 2024 (i Rishikuar I)	PL_PEF 2024 (i Rishikuar II)	Ndryshimi në vlerë (PEF Rish. II 2024 vs PEF i Miratuar 2024)	Ndryshimi në % (PEF Rish. II 2024 vs PEF i Miratuar 2024)
Operacionet e vijueshëm					
- Të ardhura nga shitja e energjisë:	28,765,692	23,787,658	23,036,813	(5,728,879)	-19.9%
Shitje energjie elektrike për klientët fundorë në TU 0.4 kV	11,559,308	11,660,807	11,569,912	10,604	0.1%
Shitje energjie ekeektrike për klientët në TM 6/10/20 kV	7,429,117	-	-	(7,429,117)	-100.0%
Shitje energjie elektrike për shoqëritë UK në TM 6/10/20/35 kV	1,056,558	870,441	924,331	(132,228)	-12.5%
Shitje energjie elektrike për bumbjet e transmetimit OST	-	-	-	-	0.0%
Shitje energjie elektrike për bumbjet e transmetimit KOSTT	-	-	-	-	0.0%
Shitje energjie elektrike me çmime tregu	387,368	480,437	480,437	93,069	24.0%
Shitje energjie elektrike për optimizim	-	1,205,850	362,034	362,034	100.0%
Shitje AlpeX (tregtare i regjistruar ne Burse)	-	608,638	514,859	514,859	100.0%
Të Ardhura të tjera nga faturim shtesë FSHU	-	-	-	-	0.0%
Shitje në ALPEX për bumbjet OST	4,000,207	-	-	(4,000,207)	-100.0%
Shitje në ALPEX për FSHU / FMF	-	3,735,937	4,027,036	4,027,036	100.0%
Të Ardhura Shërbime ndihmëse për OST	3,501,237	2,778,970	2,943,786	(557,451)	-15.9%
Të Ardhura Shërbime ndihmëse për KOSTT	790,055	995,141	960,176	170,122	21.5%
Shitje energjie elektrike - OST Disbalanca pozitive	38,038	61,193	48,728	10,690	28.1%
Te Ardhura te tjera operative (diferenca e çmimit ne burse OST/FSHU)	-	1,386,600	1,201,871	1,201,871	100.0%
Te Ardhura te tjera (Ashita, etc)	3,804	3,643	3,643	(161)	-4.2%
- Të ardhura të tjera operacionale	8,375	17,395	17,222	8,847	105.6%
Shuma e të Ardhurave Operative	28,774,067	23,805,053	23,054,035	(5,720,032)	-19.9%
- Materiale të para dhe të konsumueshme	199,758	204,822	157,051	(42,707)	-21.4%
- Blerje Energjie:	10,828,275	13,563,677	15,826,814	4,998,538	46.2%
Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu (import dhe tregu vendas)	8,329,433	7,742,460	10,349,140	2,019,707	24.2%
Blerje Energjie Elektrike për optimizim (import dhe tregu vendas)	-	900,249	214,219	214,219	100.0%
Kompesimi financiar për FTL për energjinë e pakthyer nga depozitimi	-	2,045,473	1,794,329	1,794,329	100.0%
Kompesim financiar për OST (çmimi i bursës - çmimin e rregulluar)	-	-	-	-	0.0%
Kompesim financiar për FSHU (çmimi i bursës - çmimin e rregulluar)	-	145,192	228,510	228,510	100.0%
Blerje energji elektrike -- ALPEX-Tregtar i rregjistruar ne Burse	-	481,531	578,089	578,089	100.0%
Blerje energjie nga Karavasta Solar Çmimi i rregulluar/ Çmimi i kontraktuar	1,949,751	1,536,851	1,768,257	(181,494)	-9.3%
Tarifë Transmetimi	5,918	4,980	4,934	(984)	-16.6%
Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave	372,419	321,712	410,048	37,629	10.1%
Blerje Shërbime ndihmëse OST	159,758	373,259	459,937	300,179	187.9%
Blerje Shërbime ndihmëse KOSTT	10,997	11,969	19,352	8,355	76.0%
Shpenzime te tjera energjie elektrike	-	-	-	-	0.0%
Shpenzime personeli	1,585,096	1,449,388	1,497,153	(87,943)	-5.5%
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	4,116,377	3,888,246	3,888,246	(228,131)	-5.5%
Shpenzime aseti gjenerues termik	8,625,290	2,478,915	1,696,143	(6,929,147)	-80.3%
Shpenzime të tjera operacionale	1,412,320	1,447,347	1,383,878	(28,442)	-2.0%
Shuma e Shpenzimeve Operative	26,767,117	23,032,396	24,449,285	(2,317,832)	-8.7%
EBIT	2,006,950	772,657	(1,395,250)	(3,402,200)	-169.5%
Të ardhura financiare	52,481	55,918	56,091	3,610	6.9%
Shpenzime financiare	687,065	739,965	739,965	52,899	7.7%
Rezultati Financiar Neto	(634,584)	(684,047)	(683,873)	(49,289)	-7.8%
Rezultati para Tatimit (EBT)	1,372,365	88,611	(2,079,124)	(3,451,489)	-251.5%
Kreditim i tatimit mbi fitimin	-	-	-	-	-
Shpenzime tatim fitimi	205,855	13,292	-	(205,855)	-100.0%
Rezultati neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm	1,166,511	75,319	(2,079,124)	(3,245,634)	-278.2%

Rishikimi i Bilancit Energjitik, solli edhe rishikimin e Programit të operacioneve të vijueshëm (tabela 2), ku ndryshimet kryesore janë:

- Të ardhurat nga operacionet e vijueshme në Rishikimin II u parashikuan me ulje gati -20% krahasuar me PEF të miratuar, duke mbartur efektin negativ të situatës hidrike jo të kënaqshme. Si rezultat, nëse në PEF original të ardhurat totale parashikoheshin rreth 28.77 Mld. Lek, në PEF e Rishikuar II, ato u planifikuan në 23.05 Mld. Lek, me një ulje gati 5.72 Mld. Lek.
- Shpenzimet për blerje/aktiviteti energjitik, rishikohen me rritje me gati +5 Mld. Lek, ose +46.2% nga plani fillestar, duke shprehur nevojën për blerje më shumë energjie, për të kompensuar prodhimin e brendshëm disi të kufizuar.
- Shpenzimet e përgjithshme të aktivitetit, u rishikuan me ulje në të gjithë zërat, me qasje të menaxhimit eficient të kostove duke i riplanifikuar më të reduktuara.
- Në total, shpenzimet e operacioneve të vijueshëm nga 26.77 Mld. Lek në planin fillestar, rishikohen në 24.45 Mld. Lek me reduktim 2.32 Mld. Lek/-8.7% më të ulta.
- Nga netimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, aktiviteti i operacioneve të vijueshëm rishikohet me rezultat negativ para tatimit (EBT) prej gati -2.08 Mld. Lek, krahasuar me planin fillestar prej +1.37 Mld. Lek. Pra shihen qartë efektet e ndryshimit të situatës hidrike, e cila ekspozon risk të lartë duke devijuar aktivitetin operativ të Korporatës.

2.3 PËRMBLEDHJE E SITUATËS HIDRIKE


Referuar portofolit aktual të gjenerimit të Korporatës, pothuajse 100% hidro, ecuria e situatës hidro-meteorologjike në aktivitetin operacional të prodhimit, merr rëndësinë kryesore në performancën e prodhimit të brendshëm. Për më tepër, kur roli i Korporatës, e ngarkuar me obligimin e furnizimit me energji elektrike për përmbushjen e DSHP, ecuria e situatës hidrike dhe menaxhimi sa më eficient i prodhimit dhe rezervës energjetike është thelbësor për të gjeneruar maksimalisht prodhim të brendshëm, që do të thotë, ulje të ekspozimit ndaj tregjeve për import.

Nga pikëpamja hidrike viti 2024 vlerësohet poshtë mesatares shumëvjeçare. Nga pikëpamja hidrologjike vitit 2024 ka qënë një vit relativisht i thatë me prurje nën mesataren 30-vjeçare (1994-2023). Treguesi kryesor referencë i prurjeve mesatare në Fierzë rezultojnë 140 m³/s nga 182 m³/s që është mesatarja shumëvjeçare, pra -42 m³/s më poshtë ose -23%, duke ndikuar në performancën e përgjithshme. Për më tepër krahasuar me vitin pozitiv 2023, diferenca është edhe më e madhe. Ecuria e reshjeve dhe rrjedhimisht e prurjeve natyrore nuk ka qënë lineare dhe e qëndrueshme por e dobët. Rrjedhimisht, evente reshjesh në prurje të mëdha hidrike nuk ka pasur. Ndërkohë, periudha e thatë e verës ka qënë relativisht e gjatë dhe e shoqëruar me temperatura mjaft të larta.

Shkurtimisht treguesit kryesorë të operim/shfrytëzimit të kaskadës së Drinit, jepen si në vijim:

- **Prurjet** mesatare në liqenin e Fierzës për 2024 rezultuan 140 m³/s, ose -28.8% më i ulët se viti 2023, ku ky tregues hidrik rezultonte në 196.5 m³/s. Po kështu, në krahasim me mesataren shumëvjeçare (1994-2023) që janë rreth 182 m³/s, rezultojnë -23 % më pak. Këto të dhëna e klasifikojnë vitin 2024 jo të favorshëm hidrologjikisht krahasuar jo vetëm me 2023, por edhe me mesataren shumëvjeçare 1994-2023.
- **Niveli** mesatar i shfrytëzimit për 2024, rezultoi 282.5 mmnd, ose -3.4 m më i ulët, krahasuar me të njëjtin tregues të 2023, prej 285.9 mmnd. Ndërsa, në krahasim me periudhën shumëvjeçare (1993-2022) prej 280.7 mmnd, rezultojnë +1.8 m më lart.
- **Rezerva Energjetike** mesatare e kaskadës në fundmuaji për 2024, rezultoi 887 GWh, ose mesatarisht – 124 GWh ose -12.2% më pak se i njëjti tregues prej 1,011 GWh i vitit 2023. Ndërkohë, po i njëjti tregues prej 887 GWh rezervë energjetike mesatare për 2024, rezultojnë +85 GWh (ose +11%) më lart se po i njëjti tregues shumëvjeçar (1994-2023) prej 802 GWh. Ky fakt tregon një menaxhim mjaft të kujdesshëm të rezervës energjetike, në kushtet e një viti jopozitiv hidrik.

Grafiku 3. Rezerva Energjitike 2024 vs 2023 (fillim muaji në GWh)




Refruar situatës jo të favorshme hidrike, nga grafiku i rezervës energjitike vërehet që Korporata ka ndjekur në ekuilibër një administrim rigoroz dhe eficient të kaskadës (për aq sa është e mundur), e orientuar në drejtim të ruajtjes së rezervës energjitike, veçanërisht për stinën e thatë.

- **Prodhimi Bruto** në kaskadën e Drinit, për vitin 2024, rezultoi 4,124 GWh, ose -202 GWh (-4.7%) më i ulët se mesatarja shumëvjeçare (1994-2023) prej 4,326 GWh, duke rezultuar me shfrytëzim më të kufizuar, si pasojë e situatës jo të favorshme hidrike.

Krahasuar me vitin pozitiv hidrik 2023 me prodhim bruto prej 5,167 GWh, kjo diferencë në prodhim rezulton edhe më e madhe, konkretisht në -1,043 GWh (-20%) më pak.

Grafiku 4. Prodhimi Bruto i Kaskadës 2024 vs 2023 (GWh)




Edhe grafikisht, konstatohet që në tërësi viti 2024 rezultoi larg volumeve të prodhuara në 2023, duke sjellë edhe prodhim krahasimisht ndjeshëm më të ulët.

2.4 TË DHËNAT KRYESORE OPERATIVE TË AKTIVITETIT TREGTAR DHE EKONOMIK

Gjatë vitit 2024, Korporata e zhvilloi veprimtarinë në fushën elektroenergjitike, për të arritur objektivat e aktivitetit të operacionet e vijueshme, që konsiston në:

- Sigurimin e volumeve të energjisë elektrike për furnizim të detyrimit për shërbimin publik;
- Ofrimin në kohë dhe me cilësinë e duhur të shërbimeve të balancimit dhe atyre ndihmëse;
- Aktivitet tregtar dhe shkëmbyes sa më dinamik, për të siguruar dhe maksimizuar të ardhura nga veprimtaria komerciale në tregun e lirë, pavarësisht situatës jo të favorshme hidrike, me objektiv rikuperimin ndaj prodhimit të reduktuar i 2024.
- Grafiku i mëposhtëm pasqyron volumet kryesore të aktivitetit të energjisë disponibël për tregtim dhe shkëmbimit/marrje për 2024, krahasuar me 2023:


Grafiku 5. Energji për tregtim + marrje - Realizim 2024 vs 2023 (MWh)



Referuar grafikut më lart, vërehet qartësisht struktura e ndryshme e flukseve hyrëse të volumeve të energjisë për 2024 kundrejt 2023, veçanërisht në:


- Prodhimi Neto i KESH për 2024, rezulton me -1,016,049 MWh/-20% më ulët, krahasuar me 2023. Pra situata jo e favorshme hidrike, ka bërë të mundur që prodhimi i brendshëm gjatë 2024 të jetë sa 66% të totalit të volumeve hyrëse të energjisë, kundrejt 73% të 2023;
- Blerja e energjisë nga tregu/importi (përfshirë Karavasta Solar), rezulton 1,172,216 MWh, pra me +608,634 MWh/+108% më e lartë, krahasuar me 2023 prej 563,582 MWh. Pra, gjatë 2024, ekspozimi ndaj tregut/importit është rritur me gati +2.1x;
- Në total, flukset hyrëse të energjisë në dispozicion të Korporatës për 2024, janë 6,245,401 MWh, ose -790,821 MWh/-11% më të ulta, krahasuar me 2023 prej 7,036,222 MWh.
- Në krahun tjetër të bilancit energjistik, pasqyrohen treguesit kryesor të flukseve dalëse të energjisë. Grafiku i mëposhtëm pasqyron volumet kryesore të energjisë së tregtuar dhe shkëmbimit/dhënie në për 2024, krahasuar me 2023.
 - Shitje OSHEE klientë tariforë FSHU/FMF/ALPEX/FTL në funksion të furnizimit për përmbushje të DSHP, rezulton me ulje me -125,666 MWh, krahasuar me 2023. Pavarësisht uljes në vlerë, duhet evidentuar që: nëse në 2023, DSHP/aktiviteti në tregun e rregulluar përbënte 82% të totalit të shitjeve, ndërkohë për 2024 ky aktivitet përbën 90% të totalit të shitjeve. Kjo rritje, kufizoi volumet energjitike dhe rrjedhimisht edhe aktivitetin në tregun e lirë gjatë 2024;

Grafiku 6. Shitje energjie + dhënie - Realizim 2024 vs 2023 (MWh)



- Shitje tregu i lirë+optimizim në 2024, janë ulur me -687,701 MWh, ose gati -5x më pak, krahasuar me 2023, duke përbërë vetëm 3% të totalit të shitjeve. Ndërkohë që ky aktivitet gjatë 2023 përbënte 12% të flukseve dalëse të totalit të shitjeve, duke përforcuar atë që u evidentua në pikën pararendëse;
- Shërbime ndihmëse/balancimi në 2024, janë rritur me +66,092 MWh, ose +49% më shumë, krahasuar me 2023, duke dhënë efekte pozitive në optimizimin ekonomik të portofolit.
- Realizimi i treguesve kryesor agregat të 2024, sipas pasqyrës të aktivitetit të operacioneve të vijueshëm të krahasuar me 2023, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 7. Të ardhura/Shpenzime - Realizim 2024 vs 2023 (Mld. Lek)



Referuar grafikut më lart, shkurtimisht evidentohet:

- Të ardhurat totale nga aktiviteti i operacioneve të vijueshëm 2024 rezultuan 26.29 Mld. Lek, ose -18.84 Mld. Lek/ -42% më i ulët, krahasuar me 2023 prej 45.13 Mld. Lek , duke pasqyruar në terma monetar, aktivitetin e reduktuar në shitje në tregun e lirë, si pasojë e situatës jo të mirë hidrike;
- Shpenzimet nga aktiviteti energjistik për 2024, janë realizuar në 18.23 Mld. Lek me rritje prej +7% ose +1.15 Mld. Lek më shumë, krahasuar me 2023. Kjo si rrjedhojë e nevojës për blerje të energjisë nga tregjet, duke shfaqur ekspozim më të lartë ndaj çmimeve të importit;
- Shpenzimet e Përgjithshme të Aktivitetit + Financiare Neto, janë në 8.05 Mld. Lek, me rritje minimale me vetëm +0.7%, krahasuar me vitin 2023. Kjo mbajtje në ekuilibër e këtij treguesi i dedikohet jo vetëm menaxhimit efektiv të kostove të përgjithshme të aktivitetit, por edhe rezultatit pozitiv neto të aktivitetit financiar;
- Si rezultat i situatës hidrike jopozitive me volume prodhimi të kufizuara duke ulur ndjeshëm të ardhurat nga aktiviteti në njërin krah dhe shpenzimeve për blerje energjie në krahun tjetër, rezultati para tatimit (EBT) i aktivitetit operativ për 2024, rezulton mjaft modest pozitiv +0.0147 Mld. Lek, dhe në kontrast me vitin mjaft pozitiv hidrik 2023, ku ky tregues rezultoi 20.06 Mld. Lek.

2.5 KOMERCIALIZIMI I MËTEJSHËM I AKTIVITETIT

Tregu i energjisë po ndryshon me ritme të shpejta në krahasim me disa vite më parë. Në mbarë globin, qeveritë po vënë në zbatim politikat kundër emetimit të karbonit dhe gjatë 5 viteve të ardhshme, shumë shtete do të kenë implementuar disa politika për reduktimin e nivelit të karbonit.

Në Shqipëri po investohet kryesisht në ndërtimin e parqeve fotovoltaike si edhe është në hapat e para orientimi investues drejt prodhimit të energjisë nëpërmjet parqeve eolike. Strategjia e diversifikimit është plotësisht në përputhje me planet për zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri dhe bashkimin e tregut me Kosovën. Në rrafshin afatgjatë, pas bashkimit të tregut, pritet që burimet tona të qëndrueshme të energjisë, të jenë në gjendje të jenë konkurruese në rajonin e Evropës Juglindore.

Miratimi dhe zhvillimi dhe i Modelit Shqiptar të Tregut ishte një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë në një treg plotësisht konkurrues të energjisë. Ndër të tjera, ky model kishte për qëllim krijimin e kushteve për një treg konkurrues të energjisë elektrike, i cili lejon vendosjen e çmimeve të drejta që burojnë nga zbatimi i një tregu të qëndrueshëm, për një treg të orientuar drejt import-eksportit, që promovon përfitimet e konsumatorëve, si dhe përfitime për sektorin shqiptar të energjisë elektrike, duke ofruar fleksibilitet për integrimin në tregun e energjisë elektrike panevropiane dhe bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (*day ahead market*) dhe tregut brenda ditës (*intraday market*), si dhe të krijonte kushtet për kalimin transparent dhe efikas të flukseve të fondeve dhe llogarive, duke përdorur ALPEX si një organizëm qendror për të gjithë tregtarët në tregun e organizuar.

Mbështetur në këtë model si dhe në legjislacionin për sektorin e energjisë në tërësi, përfshi Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike, Vendimin Nr. 456, datë 29.06.2022 të Këshillit të Ministrave dhe aktet ligjore, nënligjore e rregullatore në fuqi, KESH e ka zgjeruar aktivitetin e tij tregtar në disa drejtime.

- Nënshkrimi i një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë Elektrike me shoqërinë Karavasta Solar-sh.p.k., e cila operon një impiant fotovoltaik me kapacitet 140 MW, si dhe me shoqërinë Renco SPA. Albania, e cila operon termocentral lundruar me kapacitet prodhimi prej 110 MW ka rritur kapacitetet menaxhuese të prodhimit dhe rrjedhimisht volume të vlefshme energjie për KESH. Kjo rrit aftësinë për të mbuluar kërkesën për energji elektrike në vend në kuadër të furnizimit për DSHP, si dhe mundësinë për eksport/shitje të tregun e parregulluar të tepricave të krijuara me qëllim krijimin e të ardhurave.
- Me vendimin Nr. 519, datë 13.07.2016 «Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike», i ndryshuar, Këshilli i Ministrave miratoi Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, duke ngarkuar Ministrinë, OSHEE-sh.a., OST-sh.a. dhe KESH-sh.a. për zbatimin e këtij vendimi. Ky model ishte hapi i fundit drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë në një treg plotësisht konkurrues të energjisë, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Paragrafi 3 i VKM-së 519, përcakton rolet e modelit të tregut si dhe përcakton se të gjitha tregtimet e brendshme

afatgjata OTC do të bazohen në një kontratë financiare ku energjia elektrike fizike do të tregtohet nga ALPEX dhe çmimi i ALPEX do të jetë çmimi i referencës për kontratën financiare. Në përputhje me kërkesat e ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, në Korrik të vitit 2020, ERE aprovoi rregullat e tregut balancues, të cilat mundësojnë krijimin e një tregu konkurrues për shërbimet balancuese të kërkuara nga OST-sh.a. Me funksionimin e ALPEX dhe operimi në të i tregut të bashkuar rajonal i energjisë elektrike Shqipëri+Kosovë, janë krijuar kushtet për një treg konkurrues, që lejon vendosjen e çmimeve të cilat burojnë nga zbatimi i një tregu të qëndrueshëm dhe transparent dhe mbi të gjitha konkurrues.

Në cilësinë e Anëtarit të Bursës, aktiviteti i KESH-sh.a. konsiston në tregtimin për ditën në avancë të sasive të energjisë elektrike pas përmbushjes së detyrimit për shërbim publik sipas përcaktimeve të VKM-së 456, datë 29.06.2022.

Gjatë kësaj periudhe, KESH-sh.a. ka hedhur në treg sasi energjie elektrike me qëllim shitjen për llogari të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU-sh.a.) si dhe për llogari të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST-sh.a.) për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit.

Gjithashtu, KESH ka hedhur për shitje edhe sasi të energjisë elektrike të krijuara në kushtet e prurjeve të mëdha kur ka pasur në dispozicion të tilla.

- Me me rritjen e kapaciteteve të prodhimit, natyrisht që kërkohet edhe një integrim i teknologjive të reja e të qëndrueshme të cilat ndihmojnë aktivitetin e shoqërisë. Për këtë arsye, është investuar në përmirësimin e efikasitetit të planifikimit të prodhimit nëpërmjet implementimit të sistemeve të avancuara të kontrollit dhe monitorimit nëpërmjet të cilave bëhet i mundur përmirësimi i skenarëve të gjenerimit dhe koordinimi i plotë me mirëmbajtjet e parashikuara, shoqëruar me reagimin dinamik në rast avarish. Qasja në implementimin e teknologjive të reja dhe inovative për të rritur efikasitetin operacionale, duke thjeshtësuar proceset, vendimmarrjen dhe reagimin dinamik ndaj situatave të paparashikuara apo me potencial të lartë fitimi për Korporatën. Teknologji të tilla në programe si Platforma e Tregtimit të Energjisë Elektrike, Programi Plexos, salla e monitorimit, i shërbejnë KESH-sh.a si në proceset e prodhimit, ashtu edhe në ato të tregtimit, duke garantuar një kontroll e monitorim më të mirë të aseteve gjeneruese dhe gjithashtu, dhe në harmoni më të madhe me operacionet tregtare të energjisë elektrike.
- Përveç mënyrës së tregtimit të mëparshëm ndërmjet vetëm dy palëve, tregjet organizuara po shfaqen të përqendruara tek ankandet e çertifikatave të Garancive të Origjinës që lidhen me prodhimin e energjisë së rinovueshme të një vendi të caktuar. Në cilësinë e prodhuesit kryesor të energjisë elektrike, Korporata është angazhuar në krijimin e mundësive të tregtimit të Garancive të Origjinës që janë çertifikata elektronike të tregtueshme, që vërtetojnë se një sasi e caktuar e energjisë së konsumuar është prodhuar nga burime të rinovueshme të energjisë. Garancia e origjinës e dhënë në Shqipëri, njihet edhe nga autoritetet kompetente të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera me të cilat vendi ynë ka marrëveshje të nënshkruar për njohjen e ndërsjellë të garancive të origjinës. Për këtë arsye, KESH ka nisur procedurat e regjistrimit pranë Bursës Kroate CROPEX, me qëllim tregtimin e garancive të origjinës në tregjet rajonale.
- Në kuadër të liberalizimit të sektorit të furnizimit me pakicë për konsumatorët 20 Kv, si dhe në kushtet ku kemi shtim të kapaciteteve prodhuese si dhe diversifikimit të portofolit të prodhimit të energjisë elektrike, KESH po përballet me një transformim thelbësor të aktivitetit, jo vetëm në aspektin e diversifikimit të portofolit të klientëve e të prodhimit, por edhe në rikonceptimin e shfrytëzimit të aseteve prodhuese dhe portofolit ekonomik në tërësi.

Vlen të evidentohet se, me vënien në operim të impiantit fotovoltaiq të Karavastasë dhe me qëllim shfrytëzimin sa më efikas në të ardhmen të aseteve të tilla prodhuese që ndikojnë ndjeshëm në zgjerimin e portofolit energjitik, KESH është regjistruar pranë Zyrës së Koordinimit të Ankandëve të Kapaciteteve për Europën Juglindore (SEECAO) me synim blerjen e kapaciteteve dhe tregtimin e energjisë elektrike në tregun rajonal.

Në vijim, Korporata po synon zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit tregtar duke u regjistruar edhe në bursat e shteteve të tjera, dhe konkretisht, në Bursën e Greqisë. Kjo bursë konsiderohet si tepër e favorshme për shkak se mundëson lidhjen me tregun dhe rrjetin europian dhe duke qenë se Greqia është vend anëtar i Bashkimit Europian. KESH synon përfshirjen në këtë treg për shkak të çmimeve

të favorshme dhe mundësive më të mëdha për shtim të eksporteve dhe të diversifikimit të portofolit në përgjithësi.

Njëkohësisht, Bursa e Greqisë konsiderohet si një mundësi më e mirë për qarkullimin e sasive të energjisë që KESH parashikon të tregtojë në të ardhmen, meqenëse mes dy shteteve ekziston vetëm një border/kufi i vetëm (për shkak të pozicionit gjeografik). Për këtë arsye, si rrjedhojë e kostove më të ulëta ndërkuftare, në kuptim të qarkullimit të flukseve të energjisë, Greqia përfaqëson treg mjaft të favorshëm.

3. ZHVILLIME LIGJORE/RREGULLATORE TË LIDHURA ME AKTIVITETIN 2024

Gjatë vitit 2024, si në të gjithë periudhën e veprimtarisë së KESH, si prodhuesi i vetëm publik dhe më i madhi në vend i energjisë elektrike, zhvillimet kryesore në rrafshin ligjor/rregullator të lidhura me këtë periudhë ushtrimore, fokusohen në përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik në kuadër të furnizimit të konsumatorëve fundorë, të cilët përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit me energji elektrike.

3.1 ZHVILLIME LIGJORE

- Baza ligjore në lidhje Detyrimin e Shërbimit Publik (DSHP) të Korporatës, vijon të mbetet **VKM nr. 456, datë 29.06.2022**, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”. Vendimi i mësipërm, me përfundimin e gjendjes së emergjencës në sektor, është amenduar dy herë brenda këtij 6-mujori, fillimisht me **VKM nr. 46, datë 31.01.2024** dhe më pas me **VKM nr. 337, datë 05.06.2024**, konkretisht në vijim:

- Me **Vendimin nr. 46, datë 31.01.2024**, Këshilli i Ministrave miratoi disa shtesa dhe ndryshime në VKM bazë 456/2022, sipas të cilit, KESH-it, si shoqëri publike e prodhimit, për efekt të furnizimit të sasisë së nevojshme për klientët universalë, përveç mënyrave të tjera të sigurimit të energjisë elektrike, të përcaktuar në këtë vendim si shfrytëzim i aseteve të veta prodhuese apo të kontraktuara nga të tretët, shit-blerjes apo depozitimit për këtë qëllim, nëpërmjet transaksioneve energjetike si edhe kontratave afat-gjata shtohet edhe lejimi i KESH-it që për këtë qëllim të kryejë edhe transaksione energjetike në tregun energjetik të ditës në avancë (DAM-DayHead Market) apo tregut energjetik brenda së njëjtës ditë (IDM-IntraDay Market). Ky përcaktim formalizon, aktivitetin e Korporatës në ALPEX, për pjesën e volumeve të energjisë për furnizim për DSHP.

Gjithashtu me anë të këtij vendimi, bëhet një ndryshim në skemën e marrëdhënies KESH–FTL, duke përcaktuar që në rast të tepricave të krijuara nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, ato fillimisht do të tregtohen për nevoja të furnizimit të klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë (FTL). Ndërkohë, sasia e mbetur do të depozitohet tek shoqëria publike e prodhimit (KESH), për tu përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universal dhe sasi të rakordohen me bazë mujore dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe nevojave të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë (FTL), bazuar në sasinë dhe programet e kërkuara nga furnizuesi i tregut të lirë (FTL), për të cilat është rënë dakord ndërmjet palëve.

Po sipas këtij vendimi, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) siguron energjinë për mbulimin e humbjeve në transmetim në tregun e parregulluar të ditës në avancë ose tregun brenda së njëjtës ditë apo nëpërmjet procedurave, sipas nenit 62, të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të cilat mund të përfshijnë edhe përdorimin e instrumenteve financiarë, duke shkarkuar kështu KESH-in nga detyrimi gjatë emergjencës për të furnizuar humbjet në transmetim.

- Ndërsa me **VKM nr. 337, datë 05.06.2024**, u miratuan përsëri ndryshime në marrëdhënien KESH – FTL sipas të cilave në rast të tepricave, sasi të planifikuara për blerje në treg të parregulluar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë të jenë jo më shumë se 50% e energjisë elektrike mujore të planifikuar

për furnizim, duke i mundësuar Furnizuesit të Tregut të Lirë depozitim të shoqëria publike të prodhimit (KESH) të tepricave të energjisë elektrike dhe rimarrjen potenciale të tyre, me qëllim optimizimin e portofolit të dy shoqërive.

Ndryshimi i dytë, në këtë VKM, u pëcaktua që: “sasia e tepërt nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, pas mbulimit të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose furnizimit të klientëve në tregun e lirë, depozitohet në shoqërinë publike të prodhimit për t’u përdorur për nevoja të furnizimit të klientëve universal”.

3.2 ZHVILLIME RREGULLATORE

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), gjatë vitit 2024, miratoi disa vendime në lidhje me efekt mbi veprimtarinë e Korporatës, të përmbledhura si më poshtë:

- Vendim nr. 03, datë 22.01.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë”.

Me anën e këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës, për miratimin e procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë (DAM) Shqipëri – Kosovë”. Vendim i cili rregullon operimin në ALPEX të tregut DAM të Kosovës duke krijuar tregun e unifikuar të energjisë ndërmjet dy vendeve.

- Vendim nr. 26, datë 22.02.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Janar 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a. (FMF), për muajin Janar 2024 prej 13.80 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Pavarësisht se ky çmim nuk aplikohet nga KESH por nga FMF, duhet thënë se KESH sh.a., në bazë të Kontratës së furnizimit KESH – FSHU për vitin 2024, mund ti shesë energji elektrike FSHU/FMF për furnizimin e klientëve që kanë dalë nga sistemi i klientëve fundorë që përfitojnë nga furnizimi i shërbimit universal.

- Vendim nr.52, datë 02.04.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik në Digën e Qyrsaqit, HEC “Van i Dejës”, i shoqërisë KESH sh.a.”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik në Digën e Qyrsaqit, HEC ViD, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.

- Vendim nr. 83, datë 02.05.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2024”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2024, nga ku KESH-it, referuar licencave për aktivitetin e prodhimit, furnizimit dhe tregtimit i përcaktohet të paguajë shumën totale prej 52.169.488 Lek. Të licencuarit, subjekt i këtij vendimi duhet të kryejnë pagesat rregullatore ndaj ERE, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi, në të kundërt, do të jenë subjekt i aplikimit të masave administrative të parashikuara të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, dhe të “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave” miratuar me Vendimin nr. 125, datë 29.07.2016, të Bordit të ERE-s.

- Vendim nr. 95, datë 20.05.2024, i Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e “kontratës tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e kontratës TIP “Për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.

Me anë të kësaj kontrate, KESH sh.a i shet/furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal/FSHU, energji elektrike, për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit me çmim të rregulluar (segmenti 0.4 kV), por edhe energji elektrike për klientët për të cilët tregu i energjisë është liberalizuar në nivelet e tensionit 35/20/10/6 kV.

- Vendim nr. 102, datë 27.05.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e listës së tarifave të ALPEX për tregun brenda së njëjtës ditë”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e pjeshëm të kërkesës së subjektit ALPEX sh.a. (Bursa Shqiptare e Energjisë), për miratimin e “Listës së Tarifave për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë (DAM)”, të cilat do jenë të aplikueshme deri me 31.08.2024 për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), sipas listës që i bashkëlidhet vendimit.

- Vendim nr.110, datë, 10.06.2024, i Bordit të ERE-s “Për një ndryshim në Rregullat e Tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022”

Me anë të këtij vendimi u miratuan disa ndryshime të karakterit kryesisht procedural në lidhje me rregullat e funksionimit të bursës. Një ndryshim tjetër përcakton që sasia e energjisë elektrike e ofertuar nga KESH-i për energjinë elektrike që do të prodhohet në rastet e shkarkimit të detyruar të kaskadës dhe vendosur si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje do të renditet e treta në kurbën e grupuar të shitjeve.

- Vendim nr.148, datë, 25.07.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në Tregun e Balancimit.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s shtyu, me kërkesën dhe opinionin kryesisht të palëve balancuese të Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri (KESH sh.a., Devoll Hydropower/ Statkraft, Ayen AS Energy dhe Kurum International) shtyu deri në datën 01.03.2025, implementimin e rezolucionit të intervalit kohor 15 minutash në operimin e proceseve në tregun e balancimit dhe duke lënë në fuqi afatin 1- orësh të operimit (vendosur nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 51, datë 02.04.2024). Vendimi afekton KESH-in si subjekti kryesor balancues në tregun shqiptar të energjisë elektrike.

- Vendim nr. 171, datë, 29.08.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi listën së Tarifave ALPEX”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi që “Lista e Tarifave të ALPEX, të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 287, datë 09.10.2023, të ndryshuar, do të aplikohet deri më 31.12.2024. Vendimi afekton KESH-in si subjekt i regjistruar në ALPEX dhe që paguan tarifatat përkatëse.

- Vendim nr. 172, datë, 29.08.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 27.05.2024.”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi që “Lista e Tarifave për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë”, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 102, datë 27.05.2024 do jetë e aplikueshme deri me 31.12.2024 për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

- Vendim nr. 177, datë, 03.09.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e Kontratës Tip ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/ blerjen/ depozitimin/ shkëmbimin e energjisë elektrike”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e “Kontratës Tip për depozitimin/ shkëmbimin/shitjen/blerjen e energjisë elektrike midis shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a., sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi, të miratua nga Këshilli i Ministrave në lidhje me rregullat e funksionimit të tregut shqiptar të energjisë elektrike.

- Vendim nr. 188, datë, 12.09.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi operimin deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në Aneksin A, të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”.

Të licencuarit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që duan të ushtrojnë të drejtën e dhënë nga kjo licencë për të operuar deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në Aneksin A të Licencës, do të njoftojnë menjëherë ERE-n, sipas një formati të përcaktuar po me këtë vendim. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga depozitimi i kërkesës dhe/ose dokumentacionit në ERE, të licencuarit do t'i lëshohet një licencë me shënimin përkatës ose do t'i njoftohet informacioni/dokumentacioni që nevojitet të plotësohet.

- Vendimi nr. 265, datë 10.12.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar.”

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE miratoi disa shtesa Në “Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar, ndërmjet të tjerave miratimin e çmimeve maksimale dhe minimale kleruese dhe të urdhërporosive.

- Vendimi nr 266, datë 10.12.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e datës së fillimit të tregtimit për tregun e ankandëve brenda së njëjtës ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi miratimin e Njësisë Kohore të Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.12.2024, si dita e fillimit të tregtimit në Tregun e Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

- Vendimi nr. 267, datë 10.12.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi kërkesën e OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për ndryshimin e afatit të nominimit në tregun e balancimit”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi ndryshimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr.106, date 02.07.2020, në lidhje me kontrollin e vlefshmërisë së nominimeve dhe korrigjimin e tyre duke përcaktuar edhe shpeshtësinë dhe përditësimin e tyre brenda ditës, në 15 minuta.

- Vendimi nr. 273, datë, 13.12.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025”.

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE si autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 MW, me Vendimin si më sipër vendosi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 10 (dhjetë) lek/kWh për vitin 2025.

Miratimi i këtij çmimi, pavarësisht se bëhet për rregullimin e marrëdhënieve kontraktore dhe financiare me këtë kategori prodhuesish të energjisë elektrike ka ndikim në veprimtarinë ekonomike- financiare të KESH-it pasi çmimi i shit-blejes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi është çmimi me

të cilin KESH sh.a i shet energjinë elektrike të tepërt, pas plotësimit të kërkesës së klientëve universalë FTL për llogari të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, bazuar në VKM nr. 456, datë 29.06.2022.

- Vendim nr. 286, datë, 20.12.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e Metodologjisë për përcaktimi e tarifave të operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO)”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s miratoi “Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”. Në kapitullin e parë, përcaktohet fushëveprimi dhe qëllimi si dhe përkufizimet e përdorura në metodologji. - Në kapitullin e dytë, përcaktohen rregullat e përgjithshme të përcaktimit të të ardhurave, Rishikimet e Tarifave dhe Periudhat rregulluese. - Në kapitullin e tretë, paraqiten parimet e përgjithshme, Kostot e Lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes, Amortizimi i lejuar, Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit, Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës si dhe Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës, - Në kapitullin e katërt, përcaktohen Parimet e vendosjes së tarifave, Procesi i Miratimit të Tarifave të NEMO-s, Amendimet, Dispozita Tranzitore si dhe Hyrja në fuqi. Në nenin 12 të këtij kapitulli paraqitet procesi i miratimit të tarifave të NEMO-s, parimet e përgjithshme dhe kriteret që këto tarifa duhet të përmbushin. Në dispozitën tranzitore, është përcaktuar se kjo metodologji do të jetë e aplikueshme dhe do të shërbejë për përcaktimin e tarifave të NEMO-s për periudhën tarifore të vitit 2026 e në vazhdim. Viti 2025 do të jetë viti i testimit i cili do të shërbejë për vlerësimin e kostove faktike të realizuara nga Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike.

- Vendim nr. 299, datë 30.12.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e listës së tarifave për tregun brenda të njëjtës ditë dhe tregut të ditës në avancë”

Me këtë vendim, Bordi i ERE-s vendosi Miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a., të cilat do të jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2025.

- Vendim Nr. 300, datë 30.12.2024, i Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 24/2024, vendosi Miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, duke shfuqizuar kështu rregulloren e mëparshme. Kjo rregullore siguron përafrimin e politikave dhe parimeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë dhe përcakton procedura me fleksible sesa ajo e mëparshmeja.

- Vendim Nr. 301, datë 30.12.2024, i Bordit të ERE-s, “Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin për periudhën 01.10.2023 – 30.09.2024”.

Me anë të këtij vendimi, Bordi i ERE-s vendosi dhënien/lëshimin e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC ViD për periudhën kohore 01.12.2023 – 30.09.2024. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

4. AKTIVITETI PRODHUES, MIRËMBAJTËS DHE EFIÇENCA NË SHFRYTËZIM

4.1 PRODHIMI I ENERGISË ELEKTRIKE – OPERIMI

Nga pikëpamja hidrike viti 2024 ka qenë një vit nën-mesataren shumëvjeçare, pra hidrologjikisht ka qenë një vit relativisht i thatë në reshje dhe për rrjedhojë me prurje, poshtë treguesve shumëvjeçar. Viti 2024 është përshkruar nga prurje natyrore (për aq sa ka pasur) jo lineare dhe në kuptimin e amplitudave pa

evente të mëdha dhe të papritura hidrike. Pavarësisht reshjeve dhe prurjeve më të reduktuara, Korporata u kujdes maksimalisht për menaxhimin sa më eficient të rezervës energjetike dhe prodhim më të planifikuar. Treguesi kryesor referencë i prurjeve mesatare në Fierzë rezulton 140 m³/s nga 182 m³/s që është mesatarja 30-vjeçare (1994-2023), pra -42 m³/s më poshtë ose -23%, duke ndikuar në performancën e përgjithshme. Për më tepër, prurjet mesatare në 2024 prej 140 m³/s, janë -56 m³/s ose pothuajse -29% më pak, krahasuar me ato të 2023, prej 196 m³/s. Për rrjedhim situata hidrologjike e vitit 2024 ka rezultuar, jo vetëm poshtë treguesve shumëvjeçar por edhe më poshtë në diferencë krahasuar me vitin pararendës 2023.

Tabela 3. Prurjet dhe Prodhimi 2024 vs Mesatarja 15-vjeçare

Prurjet dhe Prodhimi	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Mesatarja 15 vjeçare
Prurjet në Fierzë (m ³ /sek)	140	196	172	233	119	121	189
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)	74.1%	103.7%	91.2%	123.3%	63.0%	64.0%	
Prodhimi Bruto i Kaskadës (GWh)	4,124	5,167	3,892	5,393	3,121	3,010	4,512
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)	91.4%	114.5%	86.3%	119.5%	69.2%	66.7%	

Shënim: Mesatarja 15 vjeçare i referohet viteve 2009-2023

Referuar edhe tabelës së mësipërme, Prurjet në Fierzë rezultojnë -26% më të ulta se mesatarja 15 vjeçare (2009-2023), duke konturuar një vit të vështirë hidrik. Gjithsesi u arrit që të prodhohej 4,124 GWh, ose sa 91.4% e mesatares së prodhimit bruto 15-vjeçar prej 4,512 GWh, duke treguar efikasitet dhe rendiment të lartë në prodhim. Kjo është e evidente, po ta krahasojmë me 2022, ku prurjet në këtë vit ishin 172 m³/s krahasuar me 140 m³/s në 2024. Ndërkohë që prodhimi i 2024 është 4,124 GWh, pra më i lartë krahasuar me 3,892 GWh të 2022. Kjo tregon që vit pas viti administrimi i kaskadës së Drinit rrit performancën, duke rritur rendimentin dhe efikasitetin në planifikim-operim, për të maksimalizuar prodhimin, pavarësisht kushteve jo të favorshme hidrike.


- Prurjet** në liqenin e Fierzës gjatë 6-mujorit I të vitit 2024 ishin rreth 180 m³/s, kjo krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 prej 251 m³/s, rezulton -28.3% më e ulët . Po kështu, në krahasim me mesataren shumëvjeçare (1994-2023) që janë rreth 244 m³/s, rezulton -26.2 % më pak. Gjatë 6-mujorit II 2024, prurjet ishin 100 m³/s në liqenin e Fierzës, kjo krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ku ishin 142 m³/s, ose -29.6% më të ulëta. Po kështu në krahasim me mesataren shumëvjeçare (1994-2023), prej 120 m³/s prurjet gjatë 6-mujorit II rezultuan rreth -16.7 % më të ulta. Në terma vjetor, prurjet mesatare në liqenin e Fierzës për 2024 rezultuan 140 m³/s, ose -28.8% më i ulët se viti 2023, ku ky tregues hidrik rezultonte në 196.5 m³/s, duke e klasifikuar vitin 2024 jo të favorshëm hidrologjikisht krahasuar jo vetëm me 2023, por edhe me mesataret 15-vjeçare dhe 30-vjeçare.
- Niveli** në liqenin e Fierzës në datë 1 Janar 2024 rezultoi në kuotën 284.49 mmnd. Krahasuar me një vit më parë (1 Janar 2023) ku kuota ishte 291.67 mmnd, viti 2024 hyn me -7.18 m më poshtë. Krahasuar me nivelin mesatar shumëvjeçar (1994-2023) prej 276.61 mmnd, niveli i liqenit të Fierzës në fillim e vitit 2024, rezultoi +7.88 m më lart. Kjo si pasojë e të gjitha eventeve të muajit Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023. Niveli gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2024 ka qënë relativisht në kuotë të lartë pothuajse mbi kuotën 284 mmnd. Pra të gjitha prurjet e ardhura në kaskadë janë menaxhuar duke minimizuar shkarkimet nga tunelet dhe duke ruajtur rezervën energjetike për stinën e verës ku prurjet janë relativisht të ulta dhe kërkesa për energji është e lartë. Niveli në liqenin e Fierzës me datë 30 Qershor 2024 rezulton në kuotën 293.40, ose rreth -2.93 m më i ulët krahasuar me një vit më parë (30 Qershor 2023) i cili kishte kuotën 296.3 mmnd. Ndërkohë, krahasuar me nivelin mesatar shumëvjeçar (1994-2023) prej 289.88 mmnd në fund muajit qershor, ky tregues për vitin 2024 rezulton +3.52 m më lart.

Pra, të gjitha prurjet e ardhura në kaskadë janë menaxhuar me kujdes duke minimizuar shkarkimet nga tunelet dhe duke ruajtur rezervën energjitike.

Niveli në fund të vitit 2024 ishte 269.22 mmnd, nga 276.61 mmnd që ka qënë mesatarisht gjatë 30-viteve të fundit (1994-2023), duke rezultuar në -7.39 m më i ulët se mesatarja shumëvjeçare. Po kështu krahasuar me të njëjtin tregues të fundvitit 2023, ku niveli ishte 284.49 mmnd, niveli në fundvitin 2024, rezultoi me -15.27 m më poshtë, pra diferenca rezultoi edhe më e madhe. Kjo tregon, një shfrytëzim më të lartë të kaskadës gjatë pjesës së dytë të 2024, për shkak se kjo periudhë e vitit 2024 rezultoi edhe më e thata nga pikëpamja hidrike.

Më poshtë grafiku, performancës së kombinuar mujore Prurje-Nivel 2024, krahasuar me mesataren shumëvjeçare:


Grafiku 8. Prurjet në Fierzë dhe Niveli Mesatar i Shfrytëzimit për 2024



- **Rezerva Energjitike** në fillim të vitit 2024 ishte 913.2 GWh ndërsa në fund të muajit qershor është 1,269 GWh. Në fund të vitit 2024 rezerva energjitike e kaskadës rezultoi 477.1 GWh, nga 665 GWh që ka qënë mesatarisht gjatë 30-viteve të fundit (1994-2023), pra gati -188 GWh më e ulët se mesatarja shumëvjeçare.

Për më tepër, krahasuar me fillimin e vitit 2023 prej 1,193 GWh, viti 2024 fillon me 913.2 GWh rezervë energjitike, ose -280 GWh. Po kështu krahasuar me fundin e vitit 2023 i cili u mbyll me rezervë energjitike prej 913 GWh, fundi i vitit 2024 u mbyll me 477 GWh, ose -436 GWh më pak (-48%), pra me diferencë të konsiderueshme, si rezultat i shfrytëzimit të lartë në pjesën e dytë të 2024, për shkak të nevojës për prodhim.

Grafiku 9. Performanca e Rezervës Energjitike në 2024



Në terma mesatar, treguesi i rezervës energjitike mesatare të kaskadës në fundmuaji për 2024, rezultoi 887 GWh, pra mesatarisht – 124 GWh ose -12.2% më pak se i njëjti tregues prej 1,011 GWh i vitit 2023.

Si rezultat, treguesit e rezervës së akumuluar energjitike të kaskadës së Drinit për vitin 2024, janë më të ulët, krahasuar me vitin pozitiv hidrik 2023.

Ndërkohë, po i njëjti tregues prej 887 GWh rezervë energjitike mesatare për 2024, rezulton +85 GWh (ose +11%) më lart se po i njëjti tregues shumëvjeçar (1994-2023), fakt ky që tregon një menaxhim mjaft të kujdesshëm të rezervës, në kushtet e një viti jopozitiv hidrik.

- **Prodhimi Bruto** në kaskadën e Drinit, për vitin 2024, rezultoi 4,124 GWh, ose -202 GWh (-4.7%) më i ulët se mesatarja shumëvjeçare (1994-2023) prej 4,326 GWh.

Krahasuar me vitin pozitiv hidrik 2023 me prodhim bruto prej 5,167 GWh, kjo diferencë në prodhim rezulton edhe më e madhe, konkretisht në -1,043 GWh (-20.2%) më pak.


Për 6-mujorin I të vitit 2024 është gjeneruar rreth 2,001,680 MWh, në krahasim me vitin 2023 që rezultoi rreth 2,823,434 MWh ose mbi -29% më pak. Ndërsa në krahasim me mesateren shumëvjeçare (1994-2023) e cila është rreth 2,398,000 MWh, prodhimi i periudhës rezulton rreth -16.5% më pak.

Gjatë 6-mujorit II të vitit 2024 prodhimi bruto rezultoi rreth 2,122,559 MWh ose rreth -9.4% më pak, në krahasim me 6-mujorin II të vitit 2023 që ishte rreth 2,343,353 MWh. Në krahasim me mesateren shumëvjeçare (1994-2023) prej 1,928,000 MWh gjatë 6-mujorit II 2024, nga kaskada është gjeneruar rreth +10 % më shumë energji elektrike.

Pavarësisht situatës jo të favorshme hidrike gjatë 2024, KESH ka shfrytëzuar dhe administruar kaskadën me mjaft eficiencë dhe kujdes duke mbajtur të balancuar treguesit e prodhimit me rezervën energjitike.

Lidhja ndërmjet Prodhimit dhe Rezervës Energjitike 2024, si treguesit kryesor ndërmjet operimit dhe administrimit të kaskadës, krahasuar me periudhën shumëvjeçare, jepet në vijim:

Grafiku 10. Prodhimi dhe Rezerva Energjitike gjatë vitit 2024



Nga grafiku i mësipërm vërehet qartësisht, rritja e rezervës energjetike gjatë 6-M I 2024, krahasuar me periudhën shumëvjeçare, dhe njëkohësisht duke plotësuar kërkesën për energji plotësisht me prodhim të brendshëm (pa import). Ndërsa 6-M II 2024, si pjesa më e thatë e vitit, paraqet rritje të shfrytëzimit, pra prodhim më të lartë krahasuar me mesataren shumëvjeçare (e kombinuar me import) për të përballuar kërkesën, ndërkohë kemi ulje të rezervës energjetike, krahasuar me mesataren e shumëvjeçare të periudhës.

- Në lidhje me performancën nga impianti PV Diga e Qyrmaq, prodhimi bruto i gjeneruar nga impianti për vitin 2024 është në total 5,179 MWh. Prodhimi më i lartë mujor është rregjistruar në Korrik me 885 MWh, ndërsa prodhimi më të ulët mujor është rregjistruar në Janar me prodhim 368 MWh.
- Referuar grafikut të mëposhtëm, konsumi i ujit/kWh të prodhuar mbetet në tërësi në nivelet e periudhës 15-vjeçare, dukej mbajtur në nivele optimale produktivitetin, në gjenerim. Kjo falë edhe mirëmbajtjes dhe investimeve rinovuese në HEC-et e kaskadës. Edhe niveli mesatar i shfrytëzimit, qëndron mjaft përafërt me treguesit respektiv të periudhës 15-vjeçare, për mbajtur ekuilibrin ndërmjet rezervës energjetike dhe prodhimit racional, gjatë ciklit vjetor të operimit të kaskadës. Ndërkohë ngarkesa mesatare e agregateve për 2024 është më lartë se mesatarja e 15-vjeçare, për të 3 HEC-et e kaskadës, duke treguar që pavarësisht vitit jopozitiv hidrik, shfrytëzimi i agregateve ka qenë më i lartë në rendiment në pjesën e operim/prodhimit. Më poshtë tabela:

Tabela 4. Efiçenca në Gjenerim gjatë vitit 2024 krahasuar me mesataren 15-vjeçare

Eficenca në Gjenerim		Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Mesatarja 15 vjeçare
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	3.84	3.74	4.09	3.98	4.09	4.04	3.89
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	282.5	285.9	276.3	283.9	279.4	277.0	282.64
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	86%	91%	86%	86%	85%	84%	84%
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.22	4.19	4.20	4.19	4.19	4.23	4.18
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	172.0	171.8	172.14	172.3	172.4	171.7	172.38
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	76%	77%	76%	79%	76%	76%	71%
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	8.34	8.45	8.48	8.49	8.28	8.45	8.46
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	74.1	73.8	73.70	73.9	73.8	74.0	74.01
	Ngarkesa Mesatare e Agregatëve (%)	86%	87%	86%	77%	78%	85%	82%

Shtim: Mesatarja 15 vjeçare i referohet viteve 2009-2023

Modeli i operimit të kaskadës tashmë dihet, ku bazuar konfigurimit të saj HEC Fierzë si HEC i sipërm dhe volum të madh rezervuari, ka rolin parësor të rregullatorit dhe depozituesit/menaxhimit të rezervës energjetike, ndërkohë dy HEC-et e tjerë dhe sidomos Komani si HEC me fuqinë më të madhe të instaluar por me liqen relativisht të vogël, kanë rolin parësor të prodhimit të energjisë.

- Tabela e mëposhtme, pasqyron krahasimin e efijencës dhe prodhimit në vite të përafërta hidro-meteorologjike.

Tabela 5. Krahasimi i prodhimit dhe efijencës në vite të përafërta hidrike

Eficenca në Gjenerim		2024	2022	2020	2019	2017
HEC Fierza	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	3.84	4.09	4.09	4.04	4.16
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	282.53	276.25	279.40	277.03	274.83
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,335	1,101	984	850	880
HEC Koman	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	4.22	4.20	4.19	4.23	4.14
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	172.03	172.14	172.38	171.66	172.96
	Energji e Prodhuar (GWh)	1,839	1,855	1,429	1,427	1,376
HEC Vau i Dejës	Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh)	8.34	8.48	8.28	8.45	8.52
	Niveli mesatar i shfrytëzimit	74.05	73.70	73.81	74.04	73.91
	Energji e Prodhuar (GWh)	951	936	708	733	689
Konsumi i ujit për Prodhim (m ³ /kWh) e Ponderuar e Kaskadës		5.047	5.199	5.084	5.204	5.170

Konsumi i ujit në prodhim (m³/kWh) në HEC Fierzë dhe HEC ViD gjatë 2024, qëndron më poshtë krahasuar me vite të përafërta hidrike. Ndërkohë që për HEC Koman ky tregues është lehtësisht më i lartë, por gjithsesi brenda normave, krahasuar edhe me vite të përafërta hidro-meteorologjike. Ndërkohë referuar tabelës, treguesi i ponderuar me prodhimin i konsumit të ujit për kaskadën për 2024 rezulton 5.047m³/s, duke qenë më i ulët, krahasuar me vite të ngjashme hidro-meteorologjike, duke treguar rritje të efijencës në shfrytëzim për cikle vjetore hidrike të krahasueshme.

- Grafiku i mëposhtëm përmbledh treguesit kryesor të shfrytëzimit dhe menaxhimit të flukseve hidrike të kaskadës, krahasuar me vite të përafërta hidrike dhe treguesit 15-vjeçar (2009-2023). Në mënyrë të përmbledhur, konkluzionet janë në vijim:
 - Nivelet e shfrytëzimit në Fierzë për 6-Mujorin I 2024 (fillim Janari dhe fillim Korriku) janë më të larta, krahasuar si për vitet e përafërta, ashtu edhe me mesataren 15-vjeçare, duke treguar prioritet ruajtjen e rezervës energjitike për periudhën e thatë;
 - Niveli në fillim Dhjetor 2024, është më i ulët krahasuar me vite të përafërta, dhe gati -11 m më poshtë se mesatarja 15-vjeçare, duke rritur shfrytëzimin gjatë pjesës II të 2024 si rezultat i prodhimit të shtuar, në këtë pjesë të thatë të vitit;

Tabela 6. Menaxhimi i Kaskadës 2024 - Analizë krahasimore me vite të përafërta hidrike

Treguesit per vitet	2024	2022	2020	2019	2017	Mesatarja 15 Vjeçare	2024 vs Diferenca/Mesatarja 15 Vjeçare
Niveli në Fillim Janar (mmnd)	284.49	275.13	275.59	266.18	281.62	279.92	4.57
Niveli në Fillim Korrik (mmnd)	293.40	287.97	291.66	292.73	272.32	291.55	1.85
Niveli në Fillim Dhjetor (mmnd)	265.45	291.67	268.69	273.17	268.90	276.37	-10.92
Rezerva Mesatare Energjitike (GWh)	897	709	746	677	616	895.51	100.2%
Prodhimi (GWh)	4,124	3,892	3,121	3,010	2,945	4,512	91.4%
Prurjet Mesatare Natyrale në Drin (m³/sek.)	241.90	309.69	207.00	221.00	216.00	313.00	77.3%
Shkarkimet nga Tunelet Fierze (million m³)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	223.79	0.0%
Shkarkimet nga Tunelet Koman (million m³)	30.40	221.63	85.80	24.30	72.51	694.83	4.4%
Shkarkimet nga Porta Vau Dejes (million m³)	24.12	361.00	172.62	0.00	52.20	925.20	2.6%
Shkarkimet totale (million m³)	54.52	582.63	258.42	24.30	124.71	1,843.82	3.0%
Kapacitetet Gjeneruese në dispozicion (MW)	1,250	1,151	1,160	1,226	1,132	1,212	103.1%

Shenim: Mesatarja 15 vjeçare i referohet viteve 2009-2023

- Rezerva energjitike mesatare gjatë 2024, është më e larta, krahasuar me vite të përafërta hidrike, bile +0.2% më e lartë se mesatarja 15-vjeçare (2009-2023), duke treguar menaxhim mjaft të kujdesshëm të kaskadës në një vit të vështirë hidrik;
- Pavarësisht se 2024 ishte një vit i thatë, vërehet që prodhimi gjatë këtij viti është më i lartë, krahasuar me vite të përafërta hidrike, dhe vetëm -9.6% më i ulët se mesatarja 15-vjeçare, duke maksimalizuar rendimentin në prodhim;
- Shkarkimet në tunele gjatë 2024 janë mjaft të ulta, krahasuar me vite të përafërta hidrike dhe përbëjnë vetëm 3% të këtij treguesi për periudhën 15-vjeçare. Kjo tregon përsëri një rritje të performancës së operim-shfrytëzimit, në aspektin e racionalitetit në planifikim.

Në përfundim, të gjithë treguesit e mësipërm të shfrytëzimit të kaskadës, tregojnë për një programim operimi racional/efiçient dhe nën monitorim të kujdesshëm për të mbajtur në ekuilibër optimal variablat Prurje – Nivel - Rezervë Energjetike - Prodhim, për siguruar parametrat më optimal të mundshëm, në një vit jo pozitiv hidrik si 2024.

4.2 SIGURIA E VEPRAVE HIDROTEKNIKE

Në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Rregullorja e Përgjithshme e Punës në KESH sh.a., Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”,

VKM-së Nr.147, datë 18.3.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, KESH sh.a., edhe gjatë viti 2024 ka realizuar në mënyrë sistematike monitorimin e gjendjes teknike dhe sigurisë së 6 (gjashtë) digave të kaskadës së lumit Drin në të tre HEC-et e kësaj kaskade që janë nën administrimin e KESH sh.a.

Bazuar në kërkesat e mësipërme lidhur me sigurinë e veprave hidroteknike, janë realizuar monitorimet dhe matje në objektet përkatëse të digave, sistemeve të shkarkimit, veprave të marrjes së ujit si dhe tek masivët rrëshqitës. Në bazë të rezultateve të matjeve dhe vërtetimeve të mësipërme është realizuar përpunimi i të dhënave si dhe analiza, interpretimi dhe raportimi i tyre në mënyrë periodike (çdo muaj), si dhe pasqyruar në Raportin Vjetor të Shfrytëzimit, Monitorimit dhe Sigurisë së Digave.

Për kontrollin dhe monitorimin e digave, informacioni i përpunuar është përfutur nga sistemet e monitorimit të instaluar në kaskadë, sikurse janë:

1. Sistemi i Monitorimit Gjeologjik

Për monitorimin gjeologjik të digave të kaskadës, është instaluar një sistem monitorimi automatik dhe manual i kombinuar me aparaturat si piezometra (me presion, pa presion), inklinometra, jointmetra, ekstensiometra.

2. Sistemi i Monitorimit Gjeodezik

Për monitorimin gjeodezik të digave të kaskadës kryhet monitorimi i rrjetit gjeodezik i përbërë nga reperë gjeodezik, monumentet gjeodezike, pika e referimi, pika nivelacioni. Monitorimi gjeodezik mat deformimet e digave dhe zonave të rrëshqitshme në koordinatat 3 dimensionale X, Y, Z.

3. Sistemi i Monitorimit Hidrologjik

Matjet kryhen në mënyrë automatike dhe transmetimi i të dhënave kryhet në kohë reale. Sektori që kryen këtë monitorim përgjatë vitit 2024 ka qenë pjesë integrale e DOP por që ka vazhduar të mbajë me informacion edhe DVHT (Departamenti i Veprave Hidro-Teknike).

4. Sistemi i Monitorimit Sizmik

Transmetimi i të dhënave kryhet online nga HEC-et në Drejtorinë e Sigurisë së Digave dhe për eventet në raste tërmetesh njoftimet vijnë në kohë reale në DVHT. Është bërë i mundur upgradi i Sistemeve të Monitorimit sizmik në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe ViD.

5. Sistemi i Monitorimit të Filtrimeve

Nëpërmjet sistemit të monitorimit të filtrimeve është bërë e mundur që matja e sasisë së filtrimeve në trupin e digës të kryhet nëpërmjet rrjetit kapërderdhësve të vendosur në galeritë e kontroll monitorimit të digave. Rezultatet e monitorimeve mbi filtrimet e ujit, përcaktojnë edhe aktivitetin prioritar për mirëmbajtjen dhe/ose rehabilitimin e tyre.

4.3 MIRËMBAJTJA DHE SHFRYTËZIMI I AGREGATEVE

Gjatë vitit 2024, Divizioni Teknik dhe veçanërisht Departamenti i Elektro-Mekanik, është përqëndruar në përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit teknik të mirëmbajtjes elektro-mekanike të aggregateve dhe pajisjeve në tre hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin, duke harmonizuar mirëmbajtjen e planifikuar periodike me mirëmbajtjen e bazuar në kushtet e pajisjeve (Condition Based Maintenance) nga sistemet online të monitorimit, mbështetur me investime elektro-mekanike për upgrade/rinovime të plota teknologjike të sistemeve ekzistuese.

Objektivi kryesor dhe i vazhdueshëm i mirëmbajtjes edhe gjatë vitit 2024, është mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve gjeneruese, nëpërmjet diagnostikimit në kohë shoqëruar me shërbime efektive mirëmbajtjeje të aggregateve, investime efektive në pajisjet dhe sistemet elektro-mekanike të rëndësishme të aggregateve, duke parandaluar avaritë e defektet apo minimizuar numrin e tyre, si dhe mbajtja në gatishmëri të vazhdueshme e pajisjeve të veprave të shkarkimit të plotave.

Ndër investimet e natyrës mirëmbajtëse/ekzistuese apo rinovuese/investuese, më kryesoret përmendim:

- Zëvendësimi i 12 ndarësave të tensionit 220 kV në Nënstacionin e HEC Fierzë. Operimi i ndarësave është i automatizuar dhe komandimi realizohet si nga vendi ashtu edhe nga distanca (Salla e komandes) nëpërmjet sistemit të kontroll-monitorimit;
- FV impiant i ri 0.4 kV i nevojave vetjake të përgjithshme të centralit në HC Koman, me dy hyrje 3,200A dhe seksionator automatike, sistem change-over e mbrojtje termomagnetike, me dalje kontrolli manual 400A dhe 800/1000A, pajisur me mbrojtje termomagnetike;
- Rinovime sistemesh VLFV 2 çelësa 3 polar 245 kV me gaz SF6 në HEC Fierze, 1 (një) çelës 3 polar 245 kV me gaz SF6 për bllokun e AG2 HEC ViDs, sistem monitorimi të parametrave për 8 çelësa në të dy HEC-e, dhe zëvendësim i 4 paneleve ndërmjetëse KKL në HEC Fierzë;
- Zëvendësimi i 10 elektro-pompave të IVP-së të agregateve në HEC ViD, dhe furnizimi i një pajisjeje profesionale me 16 kanale për matjen e vibrimeve dhe "Air Gap" për makinat rrotulluese.
- Rehabilitimi i 5 udhëzuesve të rrjetave në veprën e marrjes dhe rehabilitimi i 4 kompleteve të rrjetave në HEC ViD.

Tabela e mëposhtme përmbledh treguesit kryesorë të operimit dhe nivelit të gatishmërisë së hidro-agregatëve në HEC e kaskadës së Drinit.






Tabela 7. Operim-Gatishmëria e Hidro-Agregatëve 2019-2024

Treguesit e Mirëmbajtjes	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Mesatarja 10-Vjeçare
Orët e Punës së Agregatëve (OP)	53,932	64,171	52,035	64,622	40,302	39,324	53,563
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	<i>100.7%</i>	<i>119.8%</i>	<i>97.1%</i>	<i>120.6%</i>	<i>75.2%</i>	<i>73.4%</i>	
Orët e Agregatëve në Avari (OA)	30	27	100	67	38	6	69
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	<i>43.4%</i>	<i>38.4%</i>	<i>144.9%</i>	<i>96.8%</i>	<i>55.4%</i>	<i>8.7%</i>	
Koeficienti i Gatishmërisë së Agregatëve (OP/OP+OA, %)	99.94	99.96	99.81	99.9	99.91	99.98	99.88
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	<i>100.06%</i>	<i>100.08%</i>	<i>99.93%</i>	<i>100.02%</i>	<i>100.03%</i>	<i>100.10%</i>	
Rastet e Avari-Defekteve (RAD)	20	20	36	33	14	6	29
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	<i>69.0%</i>	<i>69.0%</i>	<i>124.1%</i>	<i>113.8%</i>	<i>48.3%</i>	<i>20.7%</i>	
Orë Pune ndërmjet Defekteve (OP/RAD)	2,697	3,209	1,445	1,958	2,879	6,554	2,177
<i>Krahasuar me mesataren 10 vjeçare (%)</i>	<i>123.9%</i>	<i>147.4%</i>	<i>66.4%</i>	<i>90.0%</i>	<i>132.2%</i>	<i>301.1%</i>	

Sbënim: Mesatarja 10 vjeçare i referohet periudhës 2014-2023

Treguesi i Orëve së Punës së Agregatëve për 2024 rezulton në 53,932 orë pune ose -10,239 orë/-16% orë pune më pak se 2023, prej 64,171 orë pune. Orët e punës së agregatëve janë tregues që varen direkt nga treguesit hidrik të vitit dhe ky krahasim është bërë ndërmjet dy viteve të ndryshëm hidrik. Krahasuar edhe me mesataren 10-vjeçare prej 53,563 orë pune, viti 2024 shënon +369/+0.7% orë pune më shumë. Ndërkohë, krahasuar me vite të përfaqësuara hidrike jo të favorshme si 2019, 2020 apo 2022, orët e punës së agregatëve gjatë 2024 janë më të larta, duke paraqitur nivel më të lartë shfrytëzimi. Më poshtë paraqitja grafike:

Grafiku 11. Treguesit e Operim-Mirëmbajtjes së Sistemeve Hidroenergjetike 2019-2024



Në Hidrocentralet e kaskadës së Drinit zbatohen planet e integruara dhe të koordinuara të remonteve kapitale, remonteve të mesme dhe ato profilaktike të njërive prodhuese, të pajisjeve të veprave të shkarkimit si dhe të pajisjeve ndihmëse.

Për 2024 treguesit e mirëmbajtjes dhe gatishmërisë vijojnë të jenë në nivele të larta, krahasuar me mesataren e 10 (dhjetë) viteve të fundit. Performanca e mirëmbajtjes është përmirësuar si rrjedhojë e gatishmërisë së lartë të njërive për operim, efikasitetit të kontrolleve të vazhdueshme parandaluese, shërbimeve cilësore të mirëmbajtjes gjatë remonteve profilaktike e të mesme, si dhe investimeve për rinovime teknologjike me pajisje të reja dhe më automatizuara në tre HEC-et e kaskadës së Drinit.

Referuar grafikëve të mësipërm, konstatohet që të gjithë treguesit e performancës për vitin 2024, janë më optimal, krahasuar me 10-vjeçarin (2014-2023), ku mund të veçojmë:

- Orët e ndërprerjeve për shkak të anomalive kalimtare kanë qenë vetëm 30, ose afërsisht -2.3x më pak se mesatarja 10-vjeçare, duke mbajtur nivel të lartë gatishmërie;
- Rastet i avarive/defekteve gjatë 2024 kanë qenë 20, ose - 31% më pak se mesatarja 10-vjeçare prej 29 orë dhe e njëjtë me 2023.
- Koeficienti i gatishmërisë së agregateve është në vlerën 99.94%, ndjeshëm më lart, krahasuar me mesataren 10-vjeçare prej 99.88%.
- Treguesi i Orëve të punës ndërmjet Avari-Difekteve për 2024 rezultoi 2,697 orë, ose 23.9% më e lartë se mesatarja 10-vjeçare prej 2,177 orë.

Për të gjitha rastet e avarive në njësitë e prodhimit të tre HEC-ve të kaskadës së Drinit, asnjëherë ndalimi i tyre nuk ka rezultuar me kohëzgjatje që imponojnë remonte të parakohshme për riparime kapitale. Është e rëndësishme të theksohet që rritja e gatishmërisë ndikon direkt edhe në shkallën e efikasitetit dhe cilësinë e prodhimit.

4.4 CILËSIA E PRODHIMIT

Hidrocentralet e kaskadës mbi lumin Drin (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC ViD) kanë në funksion sistemet e rregullimit automatik të frekuencës dhe të tensionit që garantojnë cilësinë e energjisë elektrike të prodhuar, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e kodit të rrjetit.

Korporata, ka përmbushur kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit dhe kushteve të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, dhe tashmë në të gjitha njësitë gjeneruese të secilës njësi prodhimi janë të instaluar:

1. Sistemet statike dixhitale të rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve (AVR).
2. Sistemet dixhitale të rregullimit automatik të shpejtësisë së turbinave.

Të gjithë sistemet e sipërpërmendura operohen dhe mirëmbahen nga DEM dhe sektorët e mirëmbajtjes në të tre njësitë gjeneruese të kaskadës, duke siguruar në këtë mënyrë:

- a. Cilësi dhe parametra bashkëkohorë për rregullimin e tensionit/fuqisë reaktive në dalje të njërive gjeneruese.
- b. Cilësi dhe parametra bashkëkohore për rregullimin primar dhe sekondar të frekuencës/fuqisë aktive në dalje të njërive gjeneruese.
- c. Rritje të qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar si rrjedhojë e amplifikimit të lartë dhe të stabilizimit të lëkundjeve të sistemit nga sistemet e rregullimit automatik të tensionit të gjeneratorëve me AVR dhe PSS.
- d. Siguri dhe gatishmëri e lartë në operimin e njërive gjeneruese.
- e. Rritje të sigurtisë dhe besueshmërisë së prodhimit të energjisë/furnizimit të vendit.
- f. Mbajtje në nivele optimale të konsumit të ujit dhe humbjeve në prodhim, gjatë ciklit të prodhimit të energjisë elektrike.

5. BILANCI ENERGJETIK DHE AKTIVITETI TREGTAR PËR VITIN 2024

Bilanci Energjetik i KESH sh.a. është realizuar bazuar në termat kryesorë, të mëposhtëm:

- Liçencat e aktivitetit që zotëron Shoqëria "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" (KESH) sh.a. me NUIS J61817005F në prodhim, tregtim dhe furnizim të energjisë elektrike;
- Në kuadrin ligjor/rregullator VKM Nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”;
- Marrëdhëniet kontraktuale kryesore të rrjedhura:
 - Kontrata KESH – FSHU, Nr. 1889; dt. 23.04.2024, për detyrimin për shërbim publik (furnizimin e klientëve universal) për vitin 2024;
 - Kontrata KESH-FTL, Nr. 1888/1; dt 23.04.2024, mbi shitblerjen, shkëmbimin dhe depozitimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, furnizimin e klientëve të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë si dhe plotësimin e nevojave të klientëve universal sipas rasteve të përcaktuara për vitin 2024;
 - Marrëveshja e anëtarësimit në Bursën Shqiptare të energjisë elektrike Nr. 1738, datë 28.03.2023 ndërmjet ALPEX sh.a. dhe KESH sh.a., sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike.

5.1 ANALIZA E BILANCIT ENERGJETIK

Tabela 8. Bilanci Energjetik për vitin 2024 (MWh)

Treguesit - BE 2024 KESH sh.a. (në MWh)	Viti 2024 (PEF i Miratuar)	Viti 2024 (PEF i Rishikuar II)	Viti 2024 (Realizim)	Variance (Realizim vs PEF i Rishikuar II) (MWh)	Variance (Realizim vs PEF i Rishikuar II) (%)
Prodhimi Neto KESH	4,734,214	4,061,468	4,115,433	53,965	1.3%
Energji nga Karavasta Solar T1 & T2 (PPA)	232,259	303,821	258,383	-45,438	-15.0%
Shkëmbimi KESH / marje	0	62,794	64,465	1,671	2.7%
Blerje energjie me çmime tregu (import + tregtarë vendas, VKM 456/2022)	462,131	821,121	828,027	6,906	0.8%
Blerje energjie për optimizim (import + tregtarë vendas)	0	46,450	52,718	6,268	13.5%
Marje depozitim nga FTL	0	556,151	655,338	99,187	17.8%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	168,000	196,043	187,383	-8,660	-4.4%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	0	13,221	11,059	-2,162	-16.4%
Blerje Alpex (nga tregtare te regjistruar ne Burse)	0	54,270	33,088	-21,182	-39.0%
Disbalanca negative KESH	14,400	31,189	32,232	1,043	3.3%
ASHTA Devijim pozitiv	0	3,363	7,276	3,913	116.4%
Total energji për tregtim nga KESH + shkëmbim	5,611,004	6,149,891	6,245,401	95,510	1.6%
Shitje FSHU/OSHEE - klientë tariforë (0.4 kV)	4,445,888	4,449,967	4,360,340	-89,626	-2.0%
Shitje FMF - klientë tariforë (6/10/20/kV)	619,093	0	72,195	72,195	100.0%
Shitje FMF - klientë tariforë / Alpex (6/10/20/kV)	0	390,897	351,855	-39,042	-10.0%
Shitje FSHU/OSHEE - klientë tariforë UK	185,361	162,163	169,485	7,322	4.5%
Shitje FSHU nga energjia e depozituar FTL	0	556,151	655,338	99,187	17.8%
Shitje OST humbje /ALPEX	216,000	0	0	0	0.0%
Shitje Alpex (Tregtar i regjistruar ne Burse)	0	51,787	39,951	-11,837	-22.9%
Furnizim për nevojat vetjake (Karavasta Solar+Renco)	0	2,618	2,731	112	4.3%
Kthim borxhi shoqërisë FTL, VKM 456/2022	0	232,119	249,410	17,291	7.4%
Shkëmbimi KESH / dhënie	0	6,320	11,375	5,055	80.0%
Shitje me çmime tregu (eksport + tregtarë vendas)	36,662	79,569	79,569	0	0.0%
Shitje energjie për optimizim (eksport + tregtarë vendas)	0	46,690	52,958	6,268	13.4%
OST Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	84,000	80,180	102,365	22,185	27.7%
KOSTT Shërbime ndihmëse (Energji Balancuese)	0	16,797	32,421	15,624	93.0%
Disbalanca pozitive KESH	24,000	71,702	58,257	-13,445	-18.8%
ASHTA Devijim negativ	0	2,929	7,150	4,221	144.1%
Total energji e tregtuar nga KESH + shkëmbim	5,611,004	6,149,891	6,245,401	95,510	1.6%
Disbalanca energjie për t'u verifikuar nga Operatori i Tregut (OST)	-0	-0	0	0	0%


Energji e Prodhuar + Blerje (disponibël për tregtim):

- Referuar tabelës së treguesve në volume të bilancit energjetik për 2024, rezulton që prodhimi neto ka qenë në sasinë rreth 4.12 TWh ose +1.3% nga plani i rishikuar II prej 4.06 TW. Gjithsesi ky realizim është -13% nga plani fillestar prej mbi 4.73 TWh, si efekt i vitit jo të mirë hidrik.
- Energji e blerë në treg/import përfshirë Karavasta Solar, rezultoi gati 1.09 TWh, - 3.4% më pak se plani i rishikuar II, por +56.5% më shumë, krahasuar me planin fillestar prej 0.69 TW duke rritur ekspozimin dhe varësinë ndaj importit/tregut, për shkak të prodhimit të brendshëm të limituar.
- Marrje depozitim nga FTL për mbullim humbje në shpërndarje prej gati 0.66 TWh, nga depozitimet e BRE, ose +17.8% më shumë, krahasuar me planin e rishikuar II.
- Blerje energjie për optimizim portofoli ku përfshihen edhe blerja e shërbimeve ndihmëse, disbalancat negative (OST/KOSTT) dhe devijimet (+) përlllogariten në rreth 324 GWh ose -6% më pak, krahasuar me planin e rishikuar II.

Në total, volumi i energjisë elektrike për tregtim nga KESH sh.a. ka rezultuar në sasinë mbi 6.245 TWh ose +1.6% më shumë se plani i rishikuar II.

Grafikisht, volumet hyrëse të energjisë elektrike sipas muajve për vitin 2024, paraqiten si më poshtë:

Grafiku 12. Energjia elektrike disponibël për tregtim për vitin 2024 (MWh)




Energji e Shitur (Tregtuar):

- Energjia e shitur për klientët e FSHU/FMF rezulton në sasinë në 5.61 TWh. Pra objektivi kryesor për sigurimin dhe furnizimin e energjisë për përmbushje të DSHP, është realizuar.
- Energjia elektrike e shitur në tregun e lirë/ALPEX + optimizimi ekonomik rezulton në sasinë e kufizuar prej gati 175 GWh, ose -3% më e ulët se plani i rishikuar II, prej 181 GWh.
- Kthim Borxhi FTL nga depozitimi (për mbullim humbje në shpërndarje) rezultoi në 249 GWh, ose +7.4% më lart se plani i rishikuar II 2024.
- Energji e shitur për shërbime ndihmëse, disbalancat pozitive (OST/KOSTT) dhe devijimet(-) u realizuan mbi 200 GWh ose +17%, se programimi i rishikuar II prej 172 GWh.

- Po kështu, nga volumet e depozituara nga BRE/PPE për llogari të FTL, (pas mbulimit të humbjeve në shpërndarje), i janë shitur FSHU për furnizim të klientëve universal rreth 655 GWh, ose rreth +18% më shumë nga plani i rishikuar II, si rritje e nevojës për përdorimin e tyre për plotësim DSHP.

Grafikisht, volumet dalëse të energjisë elektrike sipas muajve për vitin 2024, paraqiten si më poshtë:

Grafiku 13. Energjia elektrike e shitur për vitin 2024 (MWh)



5.2 AKTIVITETI NË PLOTËSIMIN E DSHP

Në panoramën makro, si rezultat i zhvillimit të gjithasnjëm, nevoja për energji elektrike në Shqipëri është rritur me ritëm të lartë krahasuar me disa vite më parë. I njëjti trend konsumi evidentohet edhe për klientët universalë të cilët furnizohen në atë që quhet “tregu i rregulluar i energjisë elektrike. Konkretisht, gjatë vitit 2024, KESH sh.a ka furnizuar shoqërinë FSHU/FTL në sasinë mbi 5.6 TWh, duke plotësuar volumet/nevojën e furnizimit për klientët universal, sipas detyrimit të vendosur me VKM nr. 456, datë 29.06.2022 dhe nr. 449, datë 26.07.2023 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”. Duke qenë aktiviteti kryesor dhe obligativ i Korporatës, ecuria e trendit të DSHP, merr rëndësi të posaçme. Në këtë kuadër, evidentohet që DSHP prej 5.6 TWh si nevojë e konsumatorit universal është ulur me -2.7%, krahasuar me vitin 2023 e cila ishte 5.75 TWh.

Faktor kryesor që ndikoi në këtë ulje është dalja në treg të lire e konsumatorëve të lidhur në nivel tensioni 20 kV, si rezultat e thellimit të mëtejshëm të reformave drejt liberalizimit të tregut/sectorit.


Gjithashtu, janë edhe faktorë të tjerë si shtimi i burimeve alternative të furnizimit veçanërisht PV autokonsum familjarë, por edhe ndërgjegjësimi i konsumatorit drejt përdorimit me efikasitet dhe kursimi i energjisë elektrike, ndikojnë në uljen e kërkesës për energji nga konsumatorët universal.

Edhe gjatë vitit 2024 Korporata siguroi furnizimin me energji për plotësimin e DSHP për klientët tarifor të ndarë në këto nivlele:

- Klientët tariforë të OSHEE/FSHU, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 0.4 kV, për shitje me çmim të rregulluar 2.6 Lek/kWh (pa TVSH). Përafërsisht, kjo kategori ka një konsum total prej ±4.4 TWh/vit.
- Klientët tariforë të OSHEE/FMF, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 6/10/20 kV, për shitje me çmim të rregulluar prej 12 Lek/kWh (pa TVSH). Përafërsisht kjo kategori ka një konsum prej ±1 TWh/vit.
- Klientët tariforë Ujësjellës-Kanalizime të OSHEE/FSHU, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 6/10/20/35 kV dhe me çmim të rregulluar 5.7 Lek/kWh (pa TVSH). Përafërsisht kjo kategori ka një konsum prej rreth 0.16 TWh/vit.

Pra në total, furnizimi për DSHP për 2024, u parashikua (PEF të Rishikuar II), në sasinë prej afërsisht 5,560 GWh/vit (5.56 TWh/vit).

Grafiku 14. Furnizimi – Detyrimi i Shërbimit Publik 2019-2024 (GWh)




Edhe grafikisht, identifikohet përmbushja e përgjegjësisë së KESH ndaj DSHP, duke siguruar volumet e nevojshme për klientët e segmentuar në tregun e rregulluar, duke ofruar siguri të plotë në furnizimin e energjisë elektrike.

Nga grafiku, vërehet që nga viti 2022 (gjatë gjendjes së emergjencës në sektor), si rezultat i legjislacionit bazë VKM nr. 456, datë 29.06.2022, i cili ndryshoi modelin e tregut të rregulluar të energjisë, KESH rimerr funksionin nga OSHEE Grup, për blerjen/importin e energjisë për furnizim për FSHU, për konsumatorët e shërbimit universal, në kuadër të përmbushjes së Detyrimit të Shërbimit Publik, të cilin që nga 2016 e kishte pasur OSHEE.

Pra, duke qenë se plotësimi i DSHP është obligim për tu plotësuar nga KESH ndaj OSHEE/FSHU, vetëm në sasi (jo kompensim për sasinë e palëvruar), dhe gjithashu KESH sipas legjislacionit ka në dispozicion të gjitha opsionet/mjetet për të përmbushur këtë furnizim, sipas programimit të OSHEE/FSHU, rrjedhimisht edhe planifikimi i DSHP, do të jetë mjaft i përafërt me realizimin e tij, duke qenë pothuajse të përputhshëm. Gjithsesi grafiku i mësipërm, ka rëndësi për tendencën e DSHP përgjatë viteve, veçanërisht ulja e saj është skenari më i favorshëm për Korporatën.

Mjaft e rëndësishme për DSHP, është struktura e burimeve nga ku janë siguruar volumet e energjisë në plotësimin e saj. Struktura e burimeve nga u sigurua kjo energji paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 15. Struktura e Sigurimit të Energjisë për DSHP 2024 (GWh)




Referuar strukturës së sigurimit të furnizimit për DSHP për 2024, krahasuar me 2023, rezultojnë vijim:

- Për vitin 2024, Korporata e ka plotësuar kërkesën e furnizimit për DSHP në masën 73% nga prodhimi i brendshëm, kundrejt 71% që ishte për vitin 2023. Por duhet cilësuar, që kjo rritje nuk vjen si rezultat i prodhimit më të lartë të brendshëm, por si rezultat i uljes së vet DSHP me -140 GWh më e ulët në 2024, krahasuar me 2023. Në vlerë sasiore absolute, kontributi nga prodhimi i brendshëm për DSHP rezultoi në 4,093 GWh, i njëjtë për të dy vitet si 2024 ashtu dhe 2023. Por nëse në 2024 (viti jopozitiv hidrik) kjo sasi ishte pothuaj 100% e prodhimit të brendshëm, duke mos lënë pothuajse volume disponibël për shitje në tregun e lirë, në vitin 2023 (vit pozitiv hidrik) nga prodhimi i brendshëm, përveç plotësimit të DSHP, Korporata kishte disponibël për shitje në tregun e lirë volum neto të konsiderueshëm prej 1,038 GWh;
- Gjatë vitit 2024, kërkesa për plotësim të DSHP-së u përmbush me 655 GWh ose 12% e masës së DSHP, nga volumet e depozituara nga PPE për llogari të FTL (për atë sasi energji elektrike që tepron mbas mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes), krahasuar me 1,095 GWh ose 19% për 2023, duke ulur kontributin e kësaj strukture. Duhet theksuar se kthimi i borxhit për FTL gjatë 2024 ka rezultuar 249.4 GWh, ose gati +2.4x më i lartë se ai gjatë 2023, prej 105 GWh.
- Burimi i tretë i sigurimit të volumeve të energjisë të furnizimit të DSHP-së, rezultojnë blerja nga importi/tregu i lirë. Ekspozimi ndaj këtij opsioni gjatë 2024, rezultoi 828 GWh dhe përbën 15% të masës së DSHP për 2024. Ndërkohë që, në 2023 janë importuar vetëm 561 GWh, që përbën 10% të masës së DSHP për 2023. Pra, duke krahasuar dy vitet, si rezultat i situatës më të pafavorshme hidrike në 2024, ekspozimi i Korporatës ndaj importit, është rritur me +267 GWh ose gati +48%. Në vlerë ekonomike, shpenzimi për blerjen në treg të lirë/importi i energjisë për DSHP kapi vlerën 105.6 Mln. Eur (pa TVSH) ose +70% më e lartë se vlera e importit prej 62 Mln. Eur (pa TVSH) në 2023, duke rritur ekspozimin ndaj importit. Ekspozimi ndaj importit është rritur jo vetëm në sasi por edhe në çmim. Mjafton të përmendim se nëse në periudhën Korrik-Dhjetor 2023 (periudhë gjatë së cilës u importua gjithë sasia e energjisë për 2023), çmimi mesatar base-load i HUPX figuroi në 98 Eur/MWh. Ndërkohë, për periudhën Qershor-Dhjetor 2024 (periudhë gjatë së cilës u importua gjithë sasia e energjisë për 2024), po i njëjti kuotim në HUPX rezultoi në 122 Eur/MWh, pra me një rritje prej +24.5%.

Per të optimizuar kostot e blerjes së energjisë, Korporata ka ndjekur sinjalet e tregjeve të energjisë, konkretisht të bursës HUDEX, e cila jep një parashikim të çmimeve për javë-muaj dhe vitin në avancë. Evidentohet se çmimi i siguruar nga importi i energjisë elektrike për 2024 ka qene sa 99.6% e HUPX+CBC (Cross Border Capacity), çka kjo tregon që Korporata ka optimizuar me kujdes skenarët e administrimit të kostove të importit kombinuar me treguesit e kaskades në mënyrë sa më eficiente.

- Referuar shitjeve në plotësimin e DSHP, për klientët tariforë të OSHEE/FSHU, që përfaqësojnë nivelin e tensionit 0.4 KV me çmim të rregulluar 2.6 Lek/kWh (pa TVSH), klientët ujësjellësa me çmim të rregulluar 5.7 Lek/kWh dhe klientët tariforë FMF, të tregtuar nëpërmjet FTL dhe që përfaqësojnë nivelin e tensionit 6/10/20 kV me çmim të rregulluar prej 12 Lek/kWh (pa TVSH), më poshtë pasqyrohen grafikisht pesha e sasive dhe e shitjeve përkatëse në tregun e rregulluar:

Grafiku 16. Shitje klientë FSHU vs Klientë FMF/ALPEX për 2024 (sasi & vlerë)



- Referuar grafikut të mësipërm, pjesa dërrmuese prej 91% (88%+3%) e sasisë së energjisë për DSHP lëvrohet tek FSHU për furnizim të klientëve universal të lidhur në nivel tensioni 0.4 kV+ujësjellësa dhe vetëm 9% janë lëvruar për klientët FMF, të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV, nëpërmjet FTL dhe ALPEX.

Në vlera monetare, të ardhurat nga furnizimi FSHU 0.4 kV+Ujësjellësa rezultojnë 123.8 Mln. Eur, ose 69% (64%+5%) e DSHP. Ndërkohë, të ardhurat nga furnizimi për klientët FMF nëpërmjet FTL & ALPEX, rezultojnë 55.6 Mln. Eur, ose 31% e DSHP.

Krahasuar me 2023, vërehet një ulje të peshës së Shitjeve për FMF/ALPEX si në sasi ashtu edhe në vlerë. Konkretisht, Shitjet për FMF/ALPEX në sasi për 2023 përbënin 17% të totalit, në 2024, ato përbëjnë 9% të totalit. Ndërsa në vlerë, Shitjet për FMF/ALPEX përbënin 47% të totalit, në 2024, ato janë ulur në 31% të totalit.

Këto ulje kanë si faktor kryesor thellimin të reformave të liberalizimit të tregut, ku konkretisht nga 01 Janar 2024 u liberalizua tregu për konsumatorët e lidhur në tension 20 kV. Për më tepër nga 01 Janar 2025 është liberalizuar tregu për konsumatorët e nivelit të tensionit 10 kV.


5.3 AKTIVITETE TREGTARE TË TJERA

- Si rezultat i situatës së jo të favorshme hidro-meteorologjike gjatë 2024, Korporata nuk kishte mjaftueshëm volume disponibël për shitje në tregun e lirë, si pasojë e reshjeve të pakta dhe prurjeve të

relativisht të kufizuara. Kjo reduktoi aktivitetin komercial në tregun e lirë duke krijuar të ardhura të pakta nga tregtimi i energjisë.

Grafiku i mëposhtëm, pasqyron ecurinë e shitjeve në volume dhe të ardhurat nga ky aktivitet për periudhën 2019-2024:

Grafiku 17. Shitjet e energjisë në kushtet e prurjeve për vitet 2019-2024



Referuar grafikut të mësipërm, shitjet e energjisë në volume në kushtet e prurjeve për 2024 janë vetëm 79,569 MWh, ose -8x më pak, krahasuar me vitin 2023, prej 639,537 MWh.


Në terma ekonomik, të ardhurat nga ky aktivitet rezultuan në 4.78 Mln. Eur (pa TVSH), ose -11.7x më pak se viti 2023 prej gati 56 Mln. Eur.

Varësia e lartë e performancës së shitjeve në tregun e lirë ndaj kushteve hidro-meteorologjike, dallohet qartë grafikisht. Si rezultat i ekspozimit të lartë ndaj riskut hidro-meteorologjik shitjet e kufizuara në vitet e pafavorshme hidrike 2019, 2020 dhe 2024, kanë mjaft kontrast me vitet e favorshme hidrike 2021 dhe 2023. Për vetë peshën e lartë që këto të ardhura kanë në aktivitetin tregtar, ato janë mjaft përcaktuese në performancën dhe rezultatin ekonomik-operativ të periudhës.

- Në lidhje me shërbimet e ndihmëse/balancimit për vitin 2024, ato kanë qenë në volume të konsiderueshme, krahasuar me vitin 2023. Duhet theksuar se këto shërbime janë pjesë e portofolit tregtar të optimizimit. Pavarësisht volumeve të shtuara si në blerje dhe në shitje, gjithsesi edhe për vitin 2024 volumet e blerjeve për shërbime balancimi janë përsëri më të larta se ato të shitjeve, duke treguar përsëri rolin vendimtar që ka KESH në ofrimin e këtyre shërbimeve dhe sigurinë që jep sistemit elektroenergjitik të vendit dhe më gjerë edhe atij të Kosovës, duke ofruar këto shërbime edhe për KOSTT.

Më poshtë pasqyrohet grafikisht ecuria e shërbimeve të balancimit për periudhën 5-vjeçare 2019-2024, ku janë përfshirë, aktivitetet ku përfshihen shërbimet e balancimit si: aktivizim në ngritje/ulje, aktivizim ± mFRR, disbalancat (+/-) dhe grup balancimi:

Grafiku 18. Shërbimet ndihmëse/balancimit për vitet 2019-2024




- Totali i volumit të blerjeve të shërbimeve ndihmëse/balancimit për 2024, shkon në 237,950 MWh ose +27% më shumë se 2023, prej 186,519 MWh;
- Totali i volumit të shitjeve të shërbimeve ndihmëse/balancimit për 2024, shkon në 200,193 MWh ose +49% më shumë se 2023, prej 134,101 MWh;

Pavarësisht situatës jo të favorshme hidrike, për arsye të aftësisë, sigurisë dhe garancisë që Korporata posedon në këto shërbime, duke qenë një pikë e fortë e saj, veprimtaria për ofrimin e këtyre shërbimeve gjatë vitit 2024, ka qenë dinamike.

Në terma monetarë, të ardhurat neto të krijuara nga ofrimi i shërbimit ndihmëse/balancimit për 2024 janë të konsiderueshme, kjo për faktin pasi KESH sh.a. përlogarit çmimin e energjisë balancuese që oferton me çmimin e tregut të energjisë dhe është pjesë e portofolit të optimizimit.

Më poshtë, pasqyrohet grafikisht dinamika e ecurisë së aktivitetit të netuar të KESH për shërbimet e balancimit me OST dhe KOSTI gjatë periudhës 2019-2024:


Grafiku 19. Të Ardhurat Neto nga shërbimet e Balancimit 2019-2024 (Mln. EUR)



Nga grafiku më lart, dallohet përfitueshmëria gjatë 2024 prej netimit të transaksioneve shit-blerje me OST dhe KOSTI në 13.5 Mln. Eur, nga aktivitetet e shërbimeve ndihmëse/balancimit, në kushtet e një tregu të lirë dhe me objektiv optimizimin ekonomiko-financiar, duke shfaqur një aktivitet proaktiv komercial, pavarësisht vitit të vështirë hidrik.

- Pjesë e liberalizimit të tregut të shërbimeve ndihmëse që kanë hyrë në fuqi që prej dt. 01.04.2021, dhe si burim i konsiderueshëm të ardhurash në aspektin tregtar, janë edhe të ardhurat për rezervim kapaciteti, të cilat në gamën e shërbimeve ndihmëse/balancimit i trajtojmë veçantë. Më poshtë paraqiten të ardhurat nga shitjet për rezervim kapaciteti për OST dhe KOSTT 2021-2024:

Grafiku 20. Shitje rezervim kapaciteti 2021 – 2024 (Mln. Eur.)




Të ardhurat për këtë shërbim në 2024 rezultojnë 27.34 Mln. Eur. ose mbi +9%, krahasuar me 2023. Ashtu si evidentua më lart, rezultatet pozitive tërësore të aktivitetit tregtar në shërbimet ndihmëse/balancimit, jo vetëm janë një burim i konsiderueshëm të ardhurash (veçanërisht determinuese në vite jo pozitive hidrike), por mbi të gjitha përforcojnë faktin që KESH përfaqëson operatorin më të sigurt dhe me rol të pazëvendësueshëm për balancimin dhe sigurinë e sistemit elektroenergjitik në hapësirën rajonale elektroenergjitike Shqipëri-Kosovë.

- Gjatë vitit 2024 është kryer një menaxhim eficient i portofolit energjetik i orientuar nga sinjalet e çmimeve të tregut duke shfrytëzuar “arbitrage” të çmimeve të kuotuar në tregjet e energjisë elektrike, për shit-blerje të energjisë elektrike, me qëllim optimizimin e portofolit ekonomik të shoqërisë. Pavarësisht priorititetit për plotësimin e DSHP dhe situatës jo të favorshme hidrike (me volume të kufizuara të prodhimit të brendshëm), gjatë 2024 u krye aktiviteti i kënaqshëm optimizimi ekonomik i portofolit energjetik. Përmirësimi i strategjisë së tregtimit ka dhënë efektin pozitiv në:
 - Diversifikimin e kontratave – Implementimi i Bursës ALPEX si dhe bashkimi i tregut me Kosovën ka diversifikuar protofolin e tregtimit të energjisë elektrike.
 - Menaxhimi i riskut – Përdorimi i instrumenteve të hedging për të mbrojtur të ardhurat nga luhajtjet e çmimeve ka dhënë efektin pozitiv në strategjinë e tregtimit
 - Analizë e tregut – Identifikimi i periudhave me çmime më të larta dhe orientimi i tregtisë drejt atyre momenteve është një element përbërës i qëndrueshmërisë në treg.
 - Optimizimi i kostove – Vlerësimi i strukturës së kostove për të përmirësuar marzhet e fitimit:

Tabela 9. Optimizimi i Portofolit Ekonomik 2019-2024

Transaksionet Komerciale të Optimizimit	2020			2021			2022			2023			2024		
	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)	Sasia (MWh)	Çmimi Mesatar (€/MWh)	Vlera Totale (Euro)
Blerje energjie elektrike	78,366	34.89	2,734,658	95,455	114.93	10,970,313	134,632	26.30	3,541,107	161,288	9.20	1,483,412	284,373	35.54	10,105,375
Shitje energjie elektrike	81,089	49.54	4,016,963	100,968	159.75	16,129,413	91,191	364.60	33,248,585	112,619	159.51	17,964,434	230,425	127.76	29,439,884
Efekti Financiar Neto nga optimizimi			1,282,305			5,159,100			29,707,479			16,481,022			19,334,509

Grafiku 21. Efekti i Optimizimit të Portofolit për vitet 2020-2024 (EUR)



KESH e mbylli vitin 2024 me mbi 19.33 Mln. Eur neto, prej efektit të optimizimit nga transaksionet në tregun e lirë me një diferencë/marzh çmimi mesatar të kënaqshëm prej 92.23 Eur/MWh. Efekti kryesor nga optimizimi i trasaksioneve erdhi nga aktiviteti i shërbimeve ndihmëse/balancimit, ndërsa optimizimi financiar ka qenë i reduktuar për shkak të volumeve të kufizuara në prodhimin e brendshëm. Gjithsesi, e rëndësishme është që Korporata ka rritur efektin/aftësinë optimizuese të portofolit të saj energjistik gjatë 2024 me +17% më shumë, krahasuar me 2023.

- Aktivitete të tjera në fushën tregtare gjatë 2024, përmendim:
 - Si tregtar i regjistruar në bursë, gjatë 2024, aktiviteti në ALPEX konsiston në blerje energjie 33,088 MWh dhe shitje energjie 39,951 MWh, me një marzh fitimi 225,694 Eur.
 - Që prej 2021, shkëmbimi i energjisë me KEK, për rastet e nevojave sezonale të palëve Shqipëri-Kosovë, është zhvilluar në mënyrë konstante dhe efektive, duke diversifikuar burimet hidro të Shqipërisë me ato termo të Kosovës. Gjatë 2024, KESH ka marrë 64,465 MWh energji nga KEK dhe ndërkohë ka dhënë 11,375 MWh energji tek KEK. Si rezultat, balanca e energjisë më 31.12.2024, është 3,384 MWh me KESH në pozicion dhënie ndaj KEK.
 - Si grup balancimi ndërmjet KESH-HEC Ashta, bazuar në marrëveshjen nr. 1225/5, datë 25.03.2021, të ardhurat nga tarifa për shërbim balancimi për 2024 janë 36,000 Eur.
 - Bazuar në liçencën e furnizimit Nr. 437 dhe Nr. Serie F18, Korporata gjatë 2024, ka furnizuar për nevoja konsumi vetjak Renco spa Albania (TEC Lundruës) për sasinë 1,939 MWh me vlerë 67,464 Eur. Po ashtu ka furnizuar Karavasta Solar për nevoja vetjake për sasinë 792 MWh me vlerë 83,153 Eur.

6. AKTIVITETI INVESTUES 2024

6.1 REALIZIMI I INVESTIMEVE

Në lidhje me investimet gjatë vitit 2024, Korporata është treguar e kujdesshme në menaxhimin e fondeve, për arsye të situatës jo të favorshme hidrike por dhe politikave të brendshme për menaxhimin me efikasitet të kostove në tërësi, duke përfshirë edhe investimet. Viti i vështirë hidrik 2024, reflektoi një aktivitet operativ më të moderuar, duke ekspozuar Korporatën në kufizime të cash-flow/fondeve të veta në dispozicion të dedikuara për investime. Në këto kushte, prioritet janë ato investime që paraqitën domosdoshmëri më të lartë. Gjithsesi, pavarësisht kufizimeve të mësipërme, përveç investimeve të

nevojshme/të domosdoshme, të cilat sigurojnë një aktivitet normal të shoqërisë, Korporata arriti të realizojë edhe investime me trajtë përmirësuese dhe zhvilluese afatgjatë të aktivitetit të Shoqërisë. Kryesisht, investimet janë përqendruar në investime rinovuese kapitale të nevojshme për sigurinë e veprave, për gatishmërinë e operim/shfrytëzimit të HEC-ve në kaskadën e Drint, sistemet e monitorim-kontrollit të aktivitetit operues të burimeve hidrike dhe në infrastrukturën kritike të teknologjisë dhe informacionit.

Në total realizimi i investimeve gjatë 2024 ka kapur vlerë të konsiderueshme prej 3.76 Mld. Lek. Krahasuar me Planin Ekonomik të Miratuar 2024 prej gati 6.97 Mld. Lek, investimet janë realizuar në masën rreth 54%. Po kështu, krahasuar me Planin Ekonomik të Rshikuar II prej 6.63 Mld. Lek, ky realizim përbën rreth 57% të tij. Gjithsesi, referuar një viti jo të favorshëm hidrik, ky realizim konsiderohet i lartë. Konkretisht, realizimi i 2024 është pothuajse (98.7%) sa realizimi i vitit pozitiv hidrik 2023, prej 3.8 Mld. Lek. Politika investuese e Korporatës është e fokusuar në sigurinë dhe eficientë e veprave hidrike, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve pasi asetet gjeneruese aktuale, për vetë madhësinë dhe problematikën e amortizimit të tyre në vite, kanë nevojë për investime mirëmbajtëse/rinovuese dhe modernizuese periodike.


Tabela e mëposhtme, pasqyron në mënyrë të përmbledhur, realizimin e investimeve sipas burimit të financimit dhe sipas njësive:

Tabela 10. Realizimi i Investimeve për vitet 2018-2024

VLERA E INVESTIMEVE TË REALIZUARA	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	
Investimet e vetë financuara (Mln. lekë)	1,459	384	2,262	3,347	2,325	2,675	3,744	
Investimet me financim të huaj (Mln. lekë)	917	883	1,146	1,072	427	1,132	17	
Total	2,376	1,267	3,408	4,419	2,752	3,807	3,761	
Investimet sipas Njësive (Mln. lekë)	Fierzë	662	122	822	785	142	819	261
	Koman	1,206	895	1,813	990	288	138	2,425
	Vau Dejës	355	107	422	828	531	1,903	656
	Aparati Qendror	153	143	351	1,816	1,791	947	419

- Investimet e realizuara për 2024, sipas njësive/qendrave të kostos, u shpërndanë përkatësisht në HEC Fierzë 7%; HEC Koman 65%; HEC ViD 17% dhe KESH Qendër në 11%. HEC Koman zë pjesën kryesore prej 65% të totalit të investimeve të realizuara për 2024, kjo për arsye të përqendrimit të investimit madhor të nisur në 2024 për rikonstruksionin e rrugës Qafë Qelë-Koman, e financuar nga Korporata me vlerë mbi 1.97 Mld Lek. Më poshtë grafiku përkatës:

Grafiku 22: Realizimi i Investimeve për 2024 sipas Njësive (në /Mln. Lek)




- Referuar grafikut të mëposhtëm, burimi i financimit të investimeve realizuara ndahet në raportin 99.6% me fondet e brendshme të korporatës, kundrejt vetëm 0.4% me fonde të huaja. Pra pothuajse gjithë realizimi i investimeve gjatë 2024 është realizuar me fondet e brendshme të Korporatës, mjaft i ndryshëm nga viti 2023 ku ky raport financimi ishte 70% nga fondet e brendshme të Korporatës, kundrejt 30% me fonde të huaja.

Në strukturën e brendshme të burimeve të financimit, investimet me fondet e veta janë realizuar në vlerën 3,744 Mln. Lek ose me rritje + 1,069 Mln. Lek (+40%) më shumë, krahsuar me 2023 prej 2,675 Mln. Lek.

Ndërkohë investimet financimet e huaja gjatë 2024, janë realizuar me vetëm 17 Mln. Lek, mjaft më e vogël se realizimi i 2023 prej 1,132 Mln. Lek. Duhet evidentuar se financimi i huaj për vitin 2024, ishte vetëm Shërbim konsulence për projektin e Rehabilitimit Elektro-Mekanik të HEC Fierzë. Gjithsesi, me fillimin zbatimit të projektit të Rehabilitimit Elektro-Mekanik të HEC Fierzë, ky burim financimi do të rritet ndjeshëm në periudhat e ardhshme.


Grafiku 23. Realizimi i Investimeve sipas Burimit të Financimit 2018-2024



- Në lidhje me qëllimin e realizimit të investimeve, ato ndahen në 3 drejtime kryesore si më poshtë:
 - Garantimi i sigurisë së veprave;
 - Rritja e efikasitetit në prodhim, ku përfshihen edhe shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese;
 - Përmirësimi i kushteve të punës.

Ndarja e investimeve të realizuara gjatë 2018-2024, sipas kategorive paraqitet grafikisht më poshtë:

Grafiku 24. Realizimi i Investimeve për vitet 2017-2024



Nga grafiku i mësipëm vërehet se në periudhën 2018-2021, volumi më i madh i fondit të investimeve është alokuar për rritjen/garantimin e sigurisë së veprave. Ndërsa gjatë periudhës 2022-2024, realizimi më i madh ka kaluar tek rritja e efijencës së prodhimit/kapacitetet e reja.

Kjo për 2 arsye kryesore:

- Ashtu si theksuam edhe më lart, duke qenë se garantimi i sigurisë së veprave është i lidhur më së shumti me Projektin e Sigurisë së Veprave Hidrike, i cili tashmë ka përfunduar, ka ulur peshën e këtij objektivi;
- Objektivi i Rritjes së Efijencës/kapacitetet e reja ka zënë peshë më të madhe gjatë 2024, pasi pjesa më e madhe e investimeve janë të tipit investues-rinovues në linjat elektro-mekanike, investime në fushën e teknologjisë dhe informacionit dhe në rritjen e kapaciteteve të reja, të cilat përmbushin më së shumti këtë objektiv.

Gjatë vitit 2024, sipas qëllimit/objektivit 42% e investimeve të realizuara kategorizohen me objektiv “Rritja e Efijencës/Prodhimit”, 31% kategorizohen me objektiv “Rritja e Sigurisë së Veprave Hidrike” dhe 27% për “Përmirësimin e kushteve të punës”. Shpërndarja e investimeve 2024 sipas qëllimit të realizimit është më e ekuilibruar, krahasuar me 2023. Ndërkohë vërehet rritje të objektivit “Përmirësimin e kushteve të punës”, si rezultat i investimit në rrugën Qafë Qelë – Koman, e cila përveç përfitimeve të tjera, përmirëson ndjeshëm kushtet e transportit të punonjësve të HEC Koman.

6.2 INVESTIMET E ME FONDET E HUAJA

Në lidhje me investimet e financuara me fondet e huaja nga partnerët ndërkombëtar, pas mbylljes në fund të 2023 së zbatimit të projektit madhor “Programi i Sigurisë së Veprave Hidrike”, që ndryshe njihet si “Projekti i Sigurisë së Digave”, investimet e financuara nga partnerët ndërkombëtar, janë fokusuar në projektin tjetër madhor, “Projekti i Rehabilitimit Elektro-Mekanik të HEC Fierzë:

- *Projekti për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzë*

Në bazë të ligjit Nr. 69/2021 datë 20.5.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Rehabilitimi i HEC Fierzë”.

Marrëveshja e huasë në shumën 40 Mln. EUR ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzë ratifikuar me ligjin nr 44/2022 datë 28.04.2022 ka hyrë në fuqi më datë 28.05.2022 dhe është bërë efektive më datë 23.08.2022.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje u sigurua një kredi e butë nga Banka Gjermane e Zhvillimit (KfW) e cila do të shkojë për rehabilitimin e plotë elektro-mekanik të HEC Fierza. Përveç kredisë nga Banka Gjermane e Zhvillimit KfW, nëpërmjet programit WBIF u akordua edhe një grant prej 8.72 Mln. EUR nga BE për këtë projekt.

Marrëveshja e Grantit shoqëruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, KfW Frankfurt am Main dhe KESH sh.a. për shumën 2 Mln. EUR, për masat shoqëruese rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës. Në Total projekti kap vlerën e financimit *50.72 Mln. EUR = 40 Mln. EUR Kredi + 10.72 Mln. EUR Grant.*

Kontrata me konsulentin e zbatimit tashmë është realizuar. Konsulenti i zbatimit për këtë aktivitet është përzgjedhur kompania Zviceriane AFRY, kontrata e të cilës është në zbatim.

Pikërisht investimet e realizuara me financim të huaj gjatë 2024, lidhen me konsulentin e zbatimit të projektit. Në planin e investimeve me financim të huaj për periudhën 2025-2029, janë parashikuar fondet për zbatimin e këtij projekti madhor. Procedura për zbatimin e punimeve rehabilituese elektro-mekanike është në fazë përfundimtare të tenderimi. Kjo do bëjë që edhe pjesa e investimeve të realizuara me financim të huaj, për periudhën e afërt do të rriten.

Ky projekt madhor, ka rëndësi shumë të madhe si për mirëmbajtjen ashtu si dhe për sigurinë dhe cilësinë e prodhimit, pasi lidhet me rehabilitimin Elektro-Mekanik të hidrocentralit të sipërm të rrjedhës dhe rregullator të gjithë kaskadës së Drinit, me një impakt thelbësor në menaxhimin operacional të prodhimit. Implementimi i projektit parashikon zgjatjen e garantuar operationale të veprës minimalisht me + 30 vjet dhe rritje të efikasitetit të prodhimit me gati +10%.

6.3 INVESTIMET ME FONDET E VETA

Pavarësisht se 2024 ishte një vit jopozitiv hidrik, Korporata realizoi investime të konsiderueshme me fondet e veta, duke investuar në zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë. Për më tepër, pothuajse i gjithë realizimi i investimeve u financua nga fondet e brendshme. Ashtu si theksuam edhe më lart, gjatë vitit 2024, investimet u përqëndruan për sigurinë e veprave hidro-teknike, për gatishmërinë elektro-mekanike të operim/shfrytëzimit të asetëve të gjenerimit, sistemet e monitorim-kontrollit të aktivitetit operacional dhe në infrastrukturën kritike të teknologjisë dhe informacionit.

1. Gjatë vitit 2024, ndër investimet më kryesore të Korporatës në funksion të sigurisë së veprave hidroteknike të përfunduara ose në proces zbatimi, përmendim në vijim:

- Mbilartësimi dhe ndërtimi i pritave malore në përroin e Lerinit;
- Rehabilitimi i kanaleve të kabujve në HEC Koman;
- Punime për riparimin e kavitacioneve në tunelin NR. 3 të shkarkimit HEC Koman;
- Rehabilitimi i galerisë së pjerrët në HEC Koman, F.V. dekovili i ri dhe rikonstrukcion i sheshit mes galerisë së pjerrët dhe shpatit të djathtë në Digën e HEC Koman;
- Rikonstrukcioni i rrugës Qafë Qelë – Koman;
- Mbrojtja e shpatit të djathtë të digës së Komanit;
- Rehabilitimi i dhomave të emergjencës në HEC Koman;
- Rehabilitimi i tunelit të shkarkimit pranë digës Zadejë në HEC ViD;
- Mbrojtja dhe sistemimi me prita malore i lumit të Gomsiqes në HEC ViD;
- Mirëmbajtja e sistemeve të monitorimit të digave.

2. Me fondet e vetë Korporatës janë kryer ose janë në vazhdimësi investime të profilit elektro-mekanik të karakterit riparues/rinovues dhe përditësues si:

- Riparim i dëmtimeve të turbinave të AG1 dhe AG3 në HEC Fierzë dhe në 5 agregatët e HEC ViD;
- Furnizim Vendorsje impiant shpërndarës 10kV me dy seksione zbarash, 12 çela me vakum dhe instalimi i një RTU me monitor për operatorin (HMI), për integrimin në sistemin SCADA të HEC Fierzë;
- Zëvendësimi i ndarësve, transformatorëve të tensionit, rrjetave rrethuese, zbarave fleksibël dhe elementeve të tjerë të zbarave 13.8 kV të 4 agregatëve në HEC Fierzë;
- Pajisje dhe pjesë rezervë elektrike, elektronike, mekanike për mirëmbajtjen e agregatëve dhe pajisjeve të HEC Fierzë;
- Furnizim vendorsje impiant i ri shpërndarës 6kV, përmirësimi i mbrojtjeve rele me sistem të monitorimit të qarkut të stakimit dhe integrimi i skemës së re në SCADA të HEC Koman;
- Instalim i sistemit të monitorimit të parametrave të 4 çelësave të HEC Koman;
- Furnizim vendorsje i kushinetave rrëshqitëse në aksin e rrotullimit të farfallës së droselit për 4 Agregatët në HEC Koman, dhe një set rezervë;
- Pajisje dhe pjesë rezervë elektrike, elektronike, mekanike për mirëmbajtjen e agregatëve e pajisjeve të HEC Koman;
- Zëvendësimi i 10 Elektro-pompave të IVP të agregatëve në HEC ViD, dhe furnizimi i një pajisje profesionale me 16 kanale për matjen e vibrimeve dhe "air gap" për makinat rrotulluese;
- Rehabilitim i rrjetave metalike për 4(katër) agregatët në veprën e marrjes së HEC ViD dhe rehabilitimi i udhëzuesve të rrjetave në zonën nënujore me polumbarë për 5(pesë) aggregate;
- Furnizim dhe instalim 2 çelësa 3 polar 245 kV, me gaz SF6, në HEC ViD;
- Pajisje dhe pjesë rezervë elektrike, elektronike, mekanike për mirëmbajtjen e agregatëve e pajisjeve të HEC ViD;
- Blerje pajisje portative profesionale për matje primare të transformatorëve të fuqisë, transformatorë rryme, ndarësa dhe çelësa fuqie;
- Furnizim Vendorsje të 2 (dy) kompleteve të sistemeve të Monitorimit të vazhdueshëm on-line të shkarkimeve pjesore për gjeneratorët Nr. 1 dhe Nr. 3 të HEC Fierzë, dhe mirëmbajtja për 9 setet PDGM si dhe analizimi i të dhënave të matura.

3. Në fushën e Automatizimit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për shkak të risqeve kibernetike në rajon janë ndërmarë një sërë masash të kombinuara edhe me investime për të akomoduar këto çështje në kuadër të rritjes së përshtatshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Investime kryesore me karakter TIK digitalizim procesesh-monitorim, mund të përmendim:

- Implementimi i qendërzuar i infrastruktures “Thin client” (VDI);
- Mirëmbajtja e sistemeve të monitorimit të transformatorëve të fuqisë DGA, BMT të HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC ViD për një periudhë 4-vjeçare;
- Shërbim mirëmbajtje për infrastrukturën TIK dhe network;
- Upgrade i Sistemeve të Monitorimit të Digave dhe Mirëmbajtja e tyre në HEC Fierzë, Koman, ViD;
- Shërbim implementimi për sistemin GIS në KESH sh.a;
- Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e prodhimit;

Objektivat për vitin 2025 është vazhdimi për plotësimin e standarteve dhe çertifikimit drejt ISO 27001 mbi sistemet operacionale, duke ndihmuar Departamentin e TIK dhe Automatizimit dhe Korporatës të ketë procedura, rregullore të qarta dhe funksionale për të siguruar të gjithë aktivitetin teknologjik, duke evidentuar çdo rrezikshmëri kibernetike si faktor kyç për infrastrukturën kritike.

6.4 ECURIA E PROJEKTEVE BRE

Si objektivi i rëndësishëm i zhvillimit strategjik dhe të qëndrueshëm i Korporatës është edhe rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet burimeve të diversifikuara. Kjo strategji e ndjekur nga

Korporata është në linjë me politikat dhe strategjitë kombëtare të vendosura nga Qeveria Shqiptare, dhe dokumentat strategjik të brendshëm si Plani i Menaxhimit ndaj Riskut të Ndryshimeve Klimatike, Strategjia për Zhvillimin e KESH sh.a. (Strategy in Action), Zhvillimi Strategjik i Sektorit Energjitik etj. Edhe gjatë 2024, aktiviteti i Korporatës për shtimin dhe diversifikimin e kapaciteteve të reja të burimeve të rinovueshme të energjisë, është fokusuar më së shumti tek energjia diellore.

- Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaik lundrues 13.8 MWp në liqenin e ViD:

Zhvillimi i këtij projekti po realizohet në bashkëpunim të ngushtë me BERZH, e cila ka lidhur marrëveshjen e angazhimit për financimin e këtij projekti nëpërmjet një kredie tregtare. Po kështu është u nënshkruar marrëveshja e kredisë ndërmjet kompanisë së projektit SENA sh.a., sponsorit KESH sh.a. dhe BERZH. Në fund 2024 është firmosur kontrata me zbatuesin e projektit, bashkimin e kompanive ndërkombëtare për realizimin e këtij projekti Gamma-SunGrow. Projekti është në fazën projektimit të detajuar teknik dhe më pas zbatimi.

- Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltaik 8.25 MWp në digën e Zadejës të HEC ViD:

Aktualisht projekti i impiantit të Zadejës është në fazën e daljes së lejes së ndërtimit për të vijuar me zbatimin. Parashikohet fillimi i punimeve në 2025. Objektivat dhe rëndësia e këtij projekti janë të njëjta me projektin e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrzaqit.

- Projekti për impiantin fotovoltaik 50 MWp në zonën Belsh:

Ky është një projekt në shkallë të gjerë dhe me impakt që synon diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike. Gjatë 2023, u zhvillua procesi i studimit social mjedisor nga kompania Alpage SRL. Në fillim të 2024 përfundoi procesi i studimit të fizibilitetit nga kompania Tractebel Engineering GmbH. Gjithashtu Tractebel ka përgatitur Basic Electrical Design, si dhe Minimum Functional Specifications si pjesë e specifikimeve teknike për tenderim. Aktualisht për zhvillimin e këtij projekti është angazhuar për ta financuar BERZH, nëpërmjet një kredie me terma preferencial (garanci sovranë) si dhe nëpërmjet një granti për asistencë teknike për realizimin e studimeve dhe projektit teknik. Projekti ka fituar në programin e WBIF-EIP grant për investimin, i cili është alokuar në Prill 2024. Viti 2025, parashikon përfundimin e fazës para-ndërtimore.

- Projekti për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës:

Faza I e kontratës me Kompaninë Bechtel përfshin ESIA+Basic Design+Studim Fisibiliteti. Sipas parashikimit pritet përfundimi i aktivitetëve të Fazës I dhe më pas të fillojnë përgatitjet për Fazën II të kontratës. Po kështu gjatë 2024 është përzgjedhur këshilltari financiar i cili do të konsultojë KESH, në lidhje me fushën ekonomiko-financiare të projektit. Faza e II e projektit parashikohet të vijohet në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 38/2021. Bazuar në vlerësimet e rezultateve të Fazës I, parashikohet që Faza II të përfshijë etapat e projektimit të detajuar+kontrata e ndërtimit+zbatimi i projektit. Koha e ndërtimit të veprës parashikohet rreth 5 vite.

7. AKTIVITETI EKONOMIKO-FINANCIAR PËR VITIN 2024

7.1 AKTIVITETI I OPERACIONEVE TË VIJUESHËM

Ashtu si u evidentua edhe më lart, viti 2024, rezultoi një vit i pafavorshëm hidrik duke kufizuar aktivitetin gjenerues/shfrytëzues të brendshëm. Kjo reflektoi, edhe në aktivitetin e kufizuar komercial duke dhënë rezultate më të reduktuara operativo-ekonomike për periudhën. Gjithsesi, Korporata arriti të përballojë me sukses përgjegjësitë e saj në furnizimin me energji elektrike, në funksion të pëmbushjes së DSHP. Pavarësisht kufizimeve në prodhimin e brendshëm, Korporata, arriti të kryej edhe aktivitet energjitik të admirueshëm (referuar kufizimeve) në tregun e lirë, duke shfrytëzuar përparësitë saj në ofrimin e shërbimeve ndihmëse/balancuese dhe optimizimin ekonomik të volumeve. Kufizimi hidrik i 2024 rriti ekspozimin ndaj tregjeve të energjisë, për shkak të importit më të lartë si në sasi por edhe disi në çmime krahasuar me 2023, duke ushtruar presion negativ në rezultatet e operacioneve të vijueshëm të periudhës. Në këtë situatë, Korporata rikalibroji objektivat ekonomik-financiar duke rishikuar PEF dy herë përgjatë vitit. Gjithashtu, për të amortizuar efektet në aktivitetin tregtar energjitik, Korporata u kujdes maksimalisht, për zhvilluar aktivitetin e përgjithshëm mbështetur mbi parimet e optimizimit dhe menaxhimit sa më eficient të kostove të përgjithshme të aktivitetit.

Tabela e mëposhtme përmbledh aktivitetin operativ nëpërmjet Pasqyrës P/L Operacionale të Realizuar 2024, krahasuar me PEF të Miratuar 2024 dhe të Rishikuar II 2024, ku në rubrikat kryesore evidentohen:

- Të Ardhurat operative totale të realizuara prej 26.29 Mld. Lek, janë -8.64.6% më poshtë se PEF i Miratuar prej 28.77 Mld. Lek, por me +14.03%, më të larta se PEF i Rishikuar II prej 23 Mld. Lek;
 - Shpenzimet operative totale të periudhës rezultojnë 26.73 Mld. Lek, pothuajse sa PEF i Miratuar prej 26.77 Mld. Lek, por +9.33% më të larta, krahasuar me PEF të Rishikuar II. Kjo rritje e shpenzimeve, u ndikua nga shpenzimet për blerje energjie për shkak të importit u rritën respektivisht me gati +68.3%, krahasuar me PEF të Miratuar, dhe +15.15%, krahasuar me PEF të Rishikuar II, ku sidomos pjesën e II të vitit, si rezultat i thatësisë së zgjatur, pavarësisht menaxhimit eficient dhe shfrytëzimit më të lartë të kaskadës, ekspozimi ndaj importit/tregjeve në blerje energjie u rrit.
 - Aktiviteti operacional financiar rezultoi me marzh neto prej +0.46 Mld. Lek ose gati +72% më i lartë se PEF i Miratuar prej -0.63 Mld. Lek. Pavarësisht rritjes qoftë të shpenzimeve dhe të ardhurave financiare, krahasuar si me PEF të Miratuar dhe PEF të Rishikuar 2024, rezultati i netimit të tyre mbyllet pozitivisht, ndryshe nga parashikimet përkatëse që netonin një rezultat negativ për periudhën.
 - Si efekt i të ardhurave më të ulta, shpenzimeve më larta të për blerje energjie gjatë periudhës, rezultati neto i operacioneve të vijueshëm për 2024 rezultoi negativ rreth -0.379 Mld. Lek. Gjithsesi pavarësisht këtij rezultati, humbja është mjaft e moderuar krahasuar me PEF të Rishikuar II i cili parashikonte një humbje neto prej gati -2.08 Mld. Lek, duke reduktuar humbjen operative me gati -82%. Ky amortizim i rezultatit negativ, vjen si pasojë e marzhit pozitiv financiar dhe menaxhimit me mjaft eficiencë të kostove të përgjithshme të aktivitetit të cilat rezultuan më të ulta, krahasuar si me PEF të Miratuar ashtu edhe me PEF të Rishikuar II.
- Pavarësisht rezultatit negativ neto, ai konsiderohet mjaft i ulët dhe inkurajues, duke treguar që Shoqëria, pavarësisht vështirësisë të krijuar nga situata jo e favorshme hidrike, arrin të kalojë situata operative “stress test”, të cilat falë punës dhe eficiencës, amortizojnë në maksimum efektet negative të riskut sistematik hidrik.

Shënim: Të dhënat ekonomik-financiare të paraqitura në këtë kapitull janë të stadit operacional, subjekt rishikimi dhe për rrjedhojë të paçertifikuara ende nga audituesit.


Tabela 11. Pasqyra Operacionale e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2024

AKTIVITETI I SHOQËRISË KESH SH.A. PËR VITIN 2024

<i>P & L Operacional 2024 (Shumat janë të shprehura në mijë lekë)</i>	PL_PEF 2024 (i Miratuar)	PL_PEF 2024 (i Rishikuar I)	PL_PEF 2024 (i Rishikuar II)	PL 2024 Realizimi (Operacional)	Ndryshimi në vlerë (Realizim 2024 vs PEF i Miratuar 2024)	Ndryshimi në % (Realizim 2024 vs PEF i Miratuar 2024)	Ndryshimi në vlerë (Realizim 2024 vs PEF i Rishikuar II 2024)	Ndryshimi në % (Realizim 2024 vs PEF i Rishikuar II 2024)
Operacionet e vijueshëm								
- Të ardhura nga shitja e energjisë:	28,765,692	23,787,658	23,036,813	25,029,013.68	(3,736,678.03)	-12.99%	1,992,201.01	8.65%
<i>Shitje energjie elektrike për klientët fundorë në TU 0.4 kV</i>	11,559,308	11,660,807	11,569,912	11,336,884.36	(222,424.09)	-1.92%	(233,028.08)	-2.01%
<i>Shitje energjie elektrike për klientët në TM 6/10/20 kV</i>	7,429,117	-	-	866,342.44	(6,562,774.40)	-88.34%	866,342.44	100.00%
<i>Shitje energjie elektrike për shoqëritë UK në TM 6/10/20/35 kV</i>	1,056,558	870,441	924,331	966,065.17	(90,493.30)	-8.56%	41,734.48	4.52%
<i>Shitje energjie elektrike me çmime tregu</i>	387,368	480,437	480,437	720,861.66	333,494.14	86.09%	240,424.76	50.04%
<i>Shitje energjie elektrike për optimizim</i>	-	1,205,850	362,034	705,970.82	705,970.82	100.00%	343,937.28	95.00%
<i>Shitje AlpeX (tregtare i regjistruar ne Burse)</i>	-	608,638	514,859	363,592.47	363,592.47	100.00%	(151,266.38)	-29.38%
<i>Shitje në ALPEX për bumbyet OST</i>	4,000,207	-	-	-	(4,000,206.92)	-100.00%	-	0.00%
<i>Shitje në ALPEX për FSHU / FMF</i>	-	3,735,937	4,027,036	3,936,380.81	3,936,380.81	100.00%	(90,655.33)	-2.25%
<i>Të Ardhura Shërbime ndihmëse për OST</i>	3,501,237	2,778,970	2,943,786	3,538,029.11	36,791.66	1.05%	594,242.72	20.19%
<i>Të Ardhura Shërbime ndihmëse për KOSTT</i>	790,055	995,141	960,176	1,304,551.92	514,497.24	65.12%	344,375.70	35.87%
<i>Shitje energjie elektrike - OST Disbalanca pozitive</i>	38,038	61,193	48,728	53,531.45	15,493.85	40.73%	4,803.89	9.86%
<i>Të Ardhura te tjera operative (diferenca e çmimit ne burse OST/FSHU)</i>	-	1,386,600	1,201,871	1,234,084.27	1,234,084.27	100.00%	32,212.85	2.68%
<i>Të Ardhura te tjera (Ashta, etc.)</i>	3,804	3,643	3,643	2,719.20	(1,084.56)	-28.51%	(923.33)	-25.35%
- Të ardhura të tjera operacionale	8,375	17,395	17,222	1,259,756.68	1,251,381.86	1494.20%	1,242,534.50	7214.73%
Shuma e të Ardhurave Operative	28,774,067	23,805,053	23,054,035	26,288,770.36	(2,485,296.16)	-8.64%	3,234,735.51	14.03%
- Materiale të para dhe të konsumueshme	199,758	204,822	157,051	939,889.66	740,131.35	370.51%	782,838.36	498.46%
- Blerje Energjie:	10,828,275	13,563,677	15,826,814	18,225,096.16	7,396,820.81	68.31%	2,398,282.51	15.15%
<i>Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu (import dhe tregu vendas)</i>	8,329,433	7,742,460	10,349,140	10,878,490.36	2,549,057.16	30.60%	529,350.01	5.11%
<i>Blerje Energjie Elektrike për optimizim (import dhe tregu vendas)</i>	-	900,249	214,219	297,135.92	297,135.92	100.00%	82,916.86	38.71%
<i>Kompesimi financiar për FITL për energjinë e paktlyer nga depozitimi</i>	-	2,045,473	1,794,329	3,146,945.92	3,146,945.92	100.00%	1,352,616.83	75.38%
<i>Kompesim financiar për FSHU (mimi i bursës - çmimin e rregulluar)</i>	-	145,192	228,510	1,022,184.52	1,022,184.52	100.00%	793,674.84	347.33%
<i>Blerje energji elektrike - ALPEX-Tregtar i regjistruar ne Burse</i>	-	481,531	578,089	329,380.60	329,380.60	100.00%	(248,708.32)	-43.02%
<i>Blerje energjie nga Karavasta Solar Çmimi i rregulluar/ Çmimi i kontraktuar</i>	1,949,751	1,536,851	1,768,257	1,690,004.43	(259,746.52)	-13.32%	(78,252.33)	-4.43%
<i>Tarifë Transmetimi</i>	5,918	4,980	4,934	4,101.76	(1,815.90)	-30.69%	(831.84)	-16.86%
<i>Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave</i>	372,419	321,712	410,048	448,734.22	76,315.69	20.49%	38,686.35	9.43%
<i>Blerje Shërbime ndihmëse OST</i>	159,758	373,259	459,937	397,172.26	237,414.34	148.61%	(62,764.34)	-13.65%
<i>Blerje Shërbime ndihmëse KOSTT</i>	10,997	11,969	19,352	10,946.17	(50.93)	-0.46%	(8,405.55)	-43.44%
<i>Shpenzime te tjera energjie elektrike</i>	-	-	-	-	-	0.00%	-	0.00%
Shpenzime personeli	1,585,096	1,449,388	1,497,153	1,267,511.56	(317,584.43)	-20.04%	(229,641.04)	-15.34%
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	4,116,377	3,888,246	3,888,246	4,484,299.56	367,922.44	8.94%	596,053.33	15.33%
Shpenzime asetit gjenerues termik	8,625,290	2,478,915	1,696,143	1,665,458.97	(6,959,831.03)	-80.69%	(30,684.52)	-1.81%
Shpenzime të tjera operacionale	1,412,320	1,447,347	1,383,878	148,597.25	(1,263,722.97)	-89.48%	(1,235,280.74)	-89.26%
Shuma e Shpenzimeve Operative	26,767,117	23,032,396	24,449,285	26,730,853.15	(36,263.85)	-0.14%	2,281,567.90	9.33%
EBIT	2,006,950	772,657	(1,395,250)	(442,082.79)	(2,449,032.32)	-122.03%	953,167.61	68.32%
Të ardhura financiare	52,481	55,918	56,091	2,035,155.87	1,982,674.66	377.8%	1,979,064.60	352.8%
Shpenzime financiare	687,065	739,965	739,965	1,578,367.87	891,302.45	129.73%	838,403.20	113.30%
Rezultati Financiar Neto	(634,584)	(684,047)	(683,873)	456,788.00	1,091,372.22	171.98%	1,140,661.40	166.79%
Rezultati para Tatimit (EBT)	1,372,365	88,611	(2,079,124)	14,705.21	(1,357,660.10)	-98.93%	2,093,829.01	100.71%
Kreditim i tatimit mbi fitimin	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime tatim fitimi	205,855	13,292	-	393,422.88	187,568.08	91.12%	393,422.88	100.00%
Rezultati neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm	1,166,511	75,319	(2,079,124)	(378,717.67)	(1,545,228.18)	-132.47%	1,700,406.13	81.78%

Vizualisht, realizimi operacional i aktivitetit për 2024, paraqitet grafikisht si më poshtë:

Grafiku 25. Pasqyra Operacionale të Ardhura/Shpenzime 2024 ('000 Lek)



Edhe grafikisht për vitin 2024, pasqyrohet aktiviteti komercial energjistik i kufizuar në tregun e lirë+optimizimi financiar me të ardhura të reduktuara, ndërkohë shërbimet ndihmëse/balancimit janë të qenësishme. Gjithashtu dallohet qartë aktiviteti masiv në tregun e rregulluar, në funksion të furnizimit për përmbushje të DSHP.

Në krahun tjetër të shpenzimeve, dallohet qartë aktiviteti blerës energjistik me vlerë të konsiderueshme me ekspozim ndaj tregjeve, si pasojë e efektit të lartë të riskut hidrik. Gjithashtu, vërehen shpenzime të përgjithshme aktiviteti të matura me vlera në efikasitet të kostove, duke siguruar një veprimtari normale të operacioneve të vijueshëm.

Pavarësisht përpjekjeve për ta amortizuar sa më shumë, rezultati neto i operacioneve të vijueshëm rezultoi negativ. Gjithsesi, në terma të moderuar dhe theksojmë mjaft më i zbutur me gati -82% më i ulët nga parashikimi në PEF i Rishikuar II.

Pavarësisht vitit jo të favorshëm 2024, performanca e Shoqërisë nuk u shoqërua, me ndonjë subvencionim financiar nga buxheti i shtetit, duke arritur të kryej veprimtarinë pa suport.

- Në kuadër të veprimtarisë së operacioneve të vijueshëm, në terma afatshkurtër, treguesit e borxhit afatshkurtër, paraqiten në tabelën vijuese:

Tabela 12. Overdraftet dhe Normat e Interesit 2019-2024

Overdraftet dhe Normat e Interesit	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Mesatarja 5-vjeçare (2019-2023)
Totali i Huave të b.vlefshme ('000 Lekë)	5,544,242	5,665,459	6,003,291	4,974,131	7,312,205	18,472,341	8,485,486
Norma Mesatare e Interesave	1.51%	2.22%	3.21%	3.19%	2.88%	2.79%	3.23%
Shpenzimet për Interesa ('000 Lekë)	83,728	126,036	192,817	158,891	377,020	516,084	274,170

Linja e borxhit afatshkurtër/overdrafteve, është ulur në 5.54 Mld. Lek. Ekspozimi nga përdorimi i tij ka qenë i kujdesshëm. Si rezultat, shpenzimet për interesa për overdraft, janë në vlerën 83.73 Mln. Lek, më e ulët se periudha 2019-2024, duke ulur koston mesatare të interesave në 1.51%.

- Aktiviteti fiskal, përmbledhet në tabelën vijuese:

Tabela 13. Aktiviteti dhe Kontributi fiskal 2019-2024

Pagesat e Detyrimeve Tatimore ('000 Lekë)	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Mesatarja 5-vjeçare (2019-2023)
TVSH paguar te tatimet	0	-	2,174	2,094,275	780,351	2,465,257	1,068,411
Tatim fitimi	3,140,874.66	1,150,010	304,230	1,563,342	1,766,673	2,629,879	1,482,827
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	362,206.82	361,180	340,217	344,107	302,049	274,126	324,336
Taksa/Tarifa të tjera-Tatim në Burim	13,021.11	1,811	1,425	6,511	824	6,116	3,337
TOTAL	3,516,102.58	1,513,000	648,047	4,008,235	2,849,897	5,375,378	2,878,911

Referuar tabelës, kontributi fiskal për vitin 2024, rezulton mbi 3.51 Mld. Lek. më i larti që nga 2019, për arsye të vitit pozitiv 2023 dhe aftësisë paguese të Korporatës për pagesat e detyrimeve fiskale. Peshën kryesore e mban tatim fitimi prej 3.14 Mld. Lek i cili përbën 89% të totalit të pagesave fiskale. Më pas vijnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me mbi 362 Mln. Lek. Po kështu Zëri i detyrim TVSH, mbetet 0, pasi TVSH e paguar rezulton më e lartë se ajo e mbledhur. Si, rezultat kontributi në tatime për 2024 është më i lartë se mesatarja 2019-2023. Vetëm viti 2019, është më lartë se 2024, për të njëjtën arsye, rritja e aftësisë paguese të Shoqërisë ndaj detyrimeve si rezultat e vitit pozitiv paraardhës 2018.

7.2 MARRËDHËNIET BRENDA SEKTORIT ELEKTROENERGJETIK

Tashmë, tregu elektroenergjetik shqiptar me operimin e plotë bursës së energjisë, zgjerimin e sektorit privat dhe në tërësi ecurisë së reformave si liberalizimi i tregut sipas niveleve të tensionit, liberalizimi i pjesëve të tregut sipas produkteve, si tregu i balancimit, shërbimet ndihmëse etj., shtuar kësaj edhe zgjerimi rajonal (veçanërisht me Kosovën), kanë shfaqur një panoramë të re dhe më të avancuar të Modelit Shqiptar të Tregut. Gjithsesi, përgjegjësia e sektorit publik veçanërisht e KESH, OSHEE Grup dhe OST, shtuar kësaj edhe fuqinë e këtyre operatorëve, e bën sektorin publik forcën kryesore në performancën kombëtare të sektorit. Për rrjedhojë, lidhja dhe marrëdhëniet e konsiderueshme ekonomiko-financiare mes operatorëve të sektorit publik jo vetëm në stadin aktual, por edhe atyre historike të trashëguara, marrin një rëndësi të veçantë për të tre operatorët, përfshirë në këtë edhe KESH, si pjesë e këtij trinomi. Në këtë kuptim, gjendja dhe balancat e marrëdhënieve ekonomiko-financiare për vitin 2024, të Korporatës me OSHEE Grup dhe OST, paraqiten në vijim:

A. Detyrimet financiare të OSHEE Grup sh.a. ndaj KESH sh.a.

- Shlyerja e detyrimeve financiare korrente për blerje energjie nga ana e FSHU/OSHEE Group sh.a. për periudhën Janar- Dhjetor 2024, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 14. Detyrimet për faturat e energjisë elektrike të FSHU sh.a. ndaj KESH sh.a. 2024

Viti 2024	Faturimi mujor (lekë)	Arkëtimi mujor (lekë)	% e Arkëtitimit ndaj Faturimit
Janar	1,438,553,708	0	0.0%
Shkurt	1,587,027,276	0	0.0%
Mars	1,189,073,569	0	0.0%
Prill	1,016,198,394	1,397,993,696	137.6%
Maj	989,456,069	490,099,122	49.5%
Qershor	1,468,832,194	400,000,000	27.2%
Korrik	1,858,561,783	1,174,708,911	63.2%
Gusht	1,787,329,889	2,500,029,047	139.9%
Shtator	1,276,453,398	2,137,288,565	167.4%
Tetor	1,297,505,851	1,706,644,715	131.5%
Nëntor	1,638,385,055	1,741,823,712	106.3%
Dhjetor	3,833,661,221	7,086,638,488	184.9%
TOTAL	19,381,038,409	18,635,226,257	96.2%

Nga tabela e mësipërme, rezultojnë që arkëtimet e Korporatës nga FSHU përkundrajt faturimit për 2024 për furnizim DSHP, rezultojnë në masën e kënaqshme 96.2%. Kjo ecuri pozitive është më e lartë me +21.5%, krahasuar me treguesin e vitit 2023 prej 74.7%. Referuar tabelës, pavarësisht se gjatë periudhës Janar-Mars 2024 nuk ka pasur flukse hyrëse nga FSHU, më pas rikuperimi ka qenë mjaft i kënaqshëm. Ecuria e këtyre arkëtimeve ka rëndësi të veçantë, pasi të ardhurat e Korporatës nga arkëtimi për energji për shërbimin publik, zënë pjesën kryesore (rreth 70%) të shifrës së afarizimit në operacionet e vijueshme të aktivitetit energjistik. Performanca pozitive e arkëtimeve korrente ka ndikim të ndjeshëm pozitiv në rritjen cash-flown operativ hyrës, dhe nivelin likuiditetit të KESH, rrjedhimisht në aftësinë paguese ndaj detyrimeve.

- Gjendja e detyrimeve financiare të akumuluar në fund të vitit 2024, të OSHEE/FSHU sh.a. ndaj KESH sh.a. të cilat klasifikohen si “Llogari të arkëtueshme/Klientë” për Korporatën, në terma agregate deri më 31 Dhjetor 2024, paraqitet në tabelën si vijon:

Tabela 15. Detyrime të akumuluar të OSHEE/FSHU sh.a. ndaj KESH sh.a. 31 Dhjetor 2024

Llogaritë e Arkëtueshme me FSHU/OSHEE Grup	31 Djetor 2024	31 Djetor 2023	Ndryshimi 2024 vs 2023		Pesha brenda llogarive të arkëtueshme (31.12.2024)
	(Lek)		(%)		(%)
Detyrimet e Prapambetura të OSHEE Grup					
Fatura për mbulimin e humbjeve	2,537,190,148	2,537,190,148	0	0.00%	5.1%
Fatura për energjinë e klientëve tariforë (prodhimi vendas)	28,135,231,197	28,135,231,197	0	0.00%	56.9%
Fatura për penalitete	17,019,529,911	17,019,529,911	0	0.00%	34.4%
Detyrim për transferim asetesh	17,400,414	17,400,414	0	0.00%	0.0%
FSHU	1,756,800,882	11,951,736,942	-10,194,936,060	-85.30%	3.6%
TOTAL	49,466,152,551	59,661,088,612	-10,194,936,060	-17.09%	100.0%

Referuar tabelës së mësipërme, gjendja e llogarive të arkëtueshme është ulur kënaqshëm me gati -10.2 Mld. Lek, ose me -17.1% në fund 2024, duke e lehtësuar situatën e llogarive të arkëtueshme totale me

OSHEE nga 59.66 Mld. Lek, në rreth 49.47 Mld. Kjo ulje, vjen e gjitha nga ulja e detyrimeve të FSHU ndaj KESH, i cili brenda vitit është ulur me -85.3%, pra nga 11.95 Mld. Lek në fund të 2023, në 1.756 Mld. Lek në fund të 2024.

Në të kundërt pjesa tjetër e detyrimeve, të cilat janë të trashëguara më herët, mbeten të pandryshuara edhe në fund të 2024. Këto detyrime të OSHEE përbëjnë 96.4% të totalit.

- Përsa i përket shlyerjes së detyrimeve për huatë afatgjata, në zbatim të marrëveshjes së nënshkruar më 10 Mars 2009 “Marrëveshja e Ripagimit të Kredive Afatgjata”, ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), sot OSHEE Grup sh.a., e cila përmban dhe Aneksin 1 ku sipas skeduleve të çdo kredie të transferuar, janë përcaktuar vlerat e principaleve dhe interesave që duhen paguar në periudhat e caktuara, OSHEE Grup ka një detyrim korrent për periudhën vitin 2024, në vlerën mbi 480.4 Mln. Lek. Gjatë vitit 2024 nuk është kryer asnjë pagesë nga OSHEE për këto detyrime. Detyrimi i akumuluar sa vjen dhe rritet. Rrjedhimisht, deri më 31.12.2024, detyrimi i akumuluar/shërbimi i borxhit i OSHEE për huatë afatgjata të transferuara, është gati 5.5 Mld. Lek (me kosto historike), sikurse ilustruar në tabelën vijuese:

Tabela 16. Detyrimet e OSHEE ndaj KESH sh.a. për Huatë Afatgjata 31 Dhjetor 2024

Detyrimi i OSHEE për huat e transferuara (Lek)	Gjendja më 31.12.2023 me kosto historike (Lek)	Detyrime për pagesë Janar-Dhjetor 2024	Pagesa për periudhën Janar-Dhjetor 2024	Gjendja më 31.12.2024 me kosto historike (Lek)
Detyrime për huat e transferuara	10,142,887,356			10,142,887,356
Pjesa afat-shkurtër - principal (detyrim)	4,192,370,751	432,735,370	-	4,625,106,122
Pjesa afat-shkurtër - interesa (detyrim)	821,310,221	47,697,289	-	869,007,510
Pjesa afat-shkurtër - Total (detyrim)	5,013,680,973	480,432,659	-	5,494,113,632

B. Detyrimet Financiare të OST sh.a. ndaj KESH sh.a.

Në lidhje me marrëdhëniet me OST sh.a. gjatë vitit 2024, mund të evidentojmë:

- Nga OST sh.a. janë shlyer gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 detyrime për shumën rreth 4.88 Mld. Lek për faturat e energjisë për shërbimet e dhëna nga KESH, që përbëjnë 34% të totalit të detyrimit të OST. Zërat më me diferencë në moslikuidim janë detyrimet për aktivizim rezerve me likuidim vetëm 2.37 Mld. Lek ose sa 25% të faturimit prej 9.5 Mld. Lek. Gjthashtu likuidimet për disbalancat janë realizuar me vetëm 198.7 Mln. Lek, ose sa 9% e faturimit prej gati 2.13 Mld. Lek. Më poshtë tabela përmbledhëse, sipas zërave:

Tabela 17. Detyrimet e OST sh.a. ndaj KESH sh.a. për 2024

Detyrimet e OST sh.a. (Lek)	Faturim/Netim Janar-Dhjetor 2024	Arkëtim/Netim Janar-Dhjetor 2024
Fatura për shërbimet ndihmëse	2,734,359,761	2,313,729,758
Fatura për disbalancat	2,126,404,701	198,708,495
Fatura për energji elektrike për aktivizim rezerve (balancim)	9,500,357,216	2,367,049,083
Fatura për penalitete (nese ka)	-	-
TOTAL	14,361,121,678	4,879,487,336

- Ashtu si theksuam edhe më lart, moslikuidimi në kohë dhe pjesor ka krijuar detyrime të akumuluar nga OST sh.a. ndaj Korporatës për energjinë elektrike të furnizuar e faturuar kryesisht për shërbimin e aktivizim rezerve/balancim, i cili përbën 66.3%, të detyrimit total. Për rrjedhim, totali i këtyre detyrimeve agregate në fund të 2024 rezulton mbi 10.7 Mld. Lek. Gjithsesi vërehet që detyrimet e prapambetura për fatura për disbalancat janë ulur me gati -6.3% dhe për shërbimet në aktivizim rezerve me -6.1%. Referuar tabelës së mëposhtme, viti 2024 u mbyll në total 10.7 Mld. Lek, ose -4% më poshtë, krahasuar me fundin e 2023 prej 11.22 Mld. Lek të “Llogarisë së arkëtueshme/klientë” (për detyrime të akumuluar nga OST). Kjo situatë ndikon negativisht në gjendjen e likuiditeteve të Korporatës dhe aftësinë paguese të saj. Llogaritë e arkëtueshme (detyrim nga OST sh.a.), përbëjnë rreth 15% të gjendjes së “Llogarive të Arkëtueshme/Klientë” në bilancin e Korporatës.

Tabela 18. Detyrimet e akumuluar të OST sh.a. ndaj KESH sh.a. 31 Dhjetor 2024

Llogaritë e Arkëtueshme me OST sh.a. (lekë)	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023	Ndryshimi 2024 vs 2023		Pesha brenda llogarive të arkëtueshme (31.12.2024)
	(lekë)		(%)	(%)	
Fatura për humbjet në sistemin e transmetimit	0	0	0	0.00%	0.0%
Fatura për shërbimet ndihmëse	420,630,003	284,000,659	136,629,343	48.1%	3.9%
Fatura për disbalancat	1,927,696,206	2,056,717,505	-129,021,299	-6.27%	17.9%
Fatura për energji elektrike për aktivizim rezerve (balancim)	7,133,308,133	7,594,275,877	(460,967,744)	-6.1%	66.3%
Fatura për penalitete	1,283,100,142	1,283,100,142	0	0.00%	11.9%
TOTAL	10,764,734,484	11,218,094,183	-453,359,699	-4.0%	100.0%

- Për vitin 2024, detyrimi financiar i OST sh.a. për interesa dhe principal për huat afatgjata është në vlerën rreth 376 Mln. lekë. Për këtë periudhë nga ana e OST sh.a. nuk është kryer pagesë ndaj detyrimit korent për huatë. Kjo situatë e pandryshuar dhe e përsëritur ka rritur detyrimin e akumuluar të Huave Afatgjata të OST ndaj KESH nga 5.02 Mld. Lek në fund të 2023 në gati 5.4 Mld. Lek në fund të vitit 2024.

Si rrjedhim, situata e detyrimeve të akumuluar për huatë e transferuara afatgjata të pashlyera nga OST sh.a. deri më 31.12.2024, paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 19. Detyrimet e OST sh.a ndaj KESH sh.a. për Huatë Afatgjata 31 Dhjetor 2024

Detyrimi i OST për huat e transferuara (lekë)	Gjendja më 31.12.2023 me kosto historike (leke)	Detyrime për pagesë Janar-Dhjetor 2024	Pagesa për periudhën Janar-Dhjetor 2024	Gjendja më 31.12.2024 me kosto historike (leke)
Detyrime për huat e transferuara	7,474,486,693			7,474,486,693
Pjesa afat-shkurtër - principal (detyrim)	4,353,930,581	322,611,013	-	4,676,541,595
Pjesa afat-shkurtër - interesa (detyrim)	664,494,503	53,243,441	-	717,737,945
Pjesa afat-shkurtër - Total (detyrim)	5,018,425,085	375,854,455	0	5,394,279,539

C. Detyrime të KESH sh.a. Huatë Afatgjata

- Vlera agregate e huave afatgjata më 31.12.2023 të KESH, kap shumën kap vlerën 72.07 Mld. Lek, praktikisht e pandryshuar krahasuar me fundin e 2023 prej 77.66 Mld. Lek. Gjatë vitit 2024, nuk ka pasur disbursime, të huave afatgjata. Në vijim, tabela e detyrimeve të Korporatës për Huatë Afatgjata:

Tabela 20. Detyrimet e KESH sh.a. për Huatë Afatgjata 31 Dhjetor 2024

Detyrimi i KESH për huatë afatgjata (lekë)	Gjendja më 31.12.2023 me kosto historike (lekë)	Disbursime Janar-Dhjetor 2024	Detyrime për pagesë Janar-Dhjetor 2024	Pagesa për periudhën Janar-Dhjetor 2024	Gjendja më 31.12.2024 me kosto historike (lekë)
Detyrime për huatë afatgjata	72,660,717,121				72,073,591,010
Pjesa afat-shkurtër - principal (detyrim)	29,754,799,527		5,588,592,608	587,126,111	34,756,266,024
Pjesa afat-shkurtër - interesa (detyrim)	4,104,221,248		1,455,818,737	656,171,153	4,903,868,832
Pjesa afat-shkurtër - Total (detyrim)	33,859,020,775		7,044,411,345	1,243,297,264	39,660,134,856

Referuar tabelës së mësipërme, Korporata ka kryer pagesa mbi 1.2 Mld. Lek principal+interesa të periudhës, një vlerë e konsiderueshme për një vit jopozitiv hidrik, por që përbën vetëm 17.6% e detyrimit korent të periudhës prej rreth 7.044 Mld. Lek. Si rezultat, ekspozimi i KESH sh.a. ndaj Ministrisë së Financave për huatë afatgjata (principal dhe interesa) të maturuara deri më 31 Dhjetor 2024, kap vlerën 39.66 Mld. Lek duke u rritur me gati 17.13%, krahasuar me fundin e 2023 kur detyrimi ishte rreth 33.86 Mld. Lek.

Në shumën e këtij detyrimi përfshihen edhe detyrimet e akumuluar për huatë afatgjata të transferuara të pashlyera nga OSHEE sh.a në vlerën rreth 5.5 Mld. Lek dhe OST sh.a. në vlerën 5.4 Mld. Lek. Pra, rritja e detyrimeve për huatë vjen edhe për shkak të shoqërive të sistemit OSHEE Grup sh.a. dhe OST sh.a., të cilat nuk kryejnë pagesat, ose në rastin më të mirë kryejnë pagesa jo të plota për detyrimet e prapambetura të këtyre huave, duke reflektuar vështirësi likuidimi tek Korporata, e cila mbetet titullare e këtyre huave ndaj MF. Pavarësisht përpjekjeve të Korporatës, situata e pafavorshme hidrike gjatë vitit 2024, ndikoi negativisht në aftësinë e saj paguese ndaj detyrimeve afatgjata, shtuar edhe situatën historike endemike të detyrimeve të akumuluar që bllokojnë likuiditetet e nevojshme, Korporata e ka ende të vështirë, likuidimin e detyrimeve në tërësi, pa mbështetjen e buxhetit të shtetit.

8. KONKLUZIONE

Referuar performancës së aktivitetit në 2024, zhvillimeve/ngjarjeve në sektorin elektroenergjetik dhe nën optikën e parashikimeve për 2025, konkluzionet kryesore janë:

- Viti 2024 përshkruhet si një vit relativisht i vështirë ushtrimor, por aktiviteti operacional i Korporatës përballoi me sukses sfidat dhe përgjegjësitë e saj në përmbushje të nevojave për furnizim. Edhe gjatë vitit 2024 Korporata si aktivitet primar kishte detyrimin të siguronte të gjithë energjinë elektrike e nevojshme për FSHU sh.a. për përmbushjen e detyrimit ndaj klientëve universal, klientëve tariforë FMF si dhe sasia e tepërt për OSSH nëpërmjet FTL për mbulimin e humbjeve në shpërndarje. Por ndryshe nga viti i pozitiv 2023, kjo përgjegjësi dhe arritja e këtij objektivi madhor u përballua me më shumë sforcë, si rezultat i situatës hidrike jo të favorshme, duke rritur ekspozimin ndaj tregjeve me importe të shtuara. Në këto kushte, Korporata, arriti të përmbush DSHP nëpërmjet prodhimit të brendshëm më të reduktur se 2023, menaxhimit efikas të depozitimeve nga PPE për mbulimin e

humbjeve në shpërndarje, dhe për rrjedhim me ekspozim më të lartë ndaj tregjeve me blerje të shtuara të sasive të energjisë. Gjithsesi, ekspozimi nga importit u amortizua disi pasi Korporata u furnizua nga Karavasta Solar sipas marrëveshjeve (PPA), në sasi të konsiderueshme energjie elektrike. Po kështu edhe asetet termike lundruese, kanë filluar të kontribuojnë në prodhimin e brendshëm. Në këtë panoramë, Shoqëria pati volume të kufizuara dhe rrjedhimisht mundësi më të reduktuara, për kryerjen e aktivitetit komercial energjie në tregun e lirë. Gjithsesi pavarësisht vështirësive, u arrit të kryhej aktiviteti tregtar, duke optimizuar ekonomikisht volumet e energjisë për sigurimin e të ardhurave shtesë nga tregtia e energjisë. Duhet theksuar që, aktiviteti pavarësisht vështirësive arriti të realizohej pa nevojën/mbështetjen financiare nga Buxheti i Shtetit, duke garantuar vazhdimësi dhe siguri edhe në periudha jo të favorshme.

- Në aspektin hidrik, viti 2024, konsiderohet një vit i pafavorshëm. Referuar indikatorëve kryesor si prurje, nivel shfrytëzimi, prodhim dhe rezervë energjitike ai paraqitet i ngjashëm me vite jo të favorshme si 2019, 2020 dhe 2022 dhe larg viteve hidrologjikisht pozitiv si 2018, 2021 dhe 2023. Eventet e reshjeve nuk kanë qenë optimale, sigurisht pa arritur të krijojnë amplituda dhe prurje/evente të mëdha hidrike. Treguesit e prurjeve natyrore, kanë qenë më të ulta jo vetëm krahasuar me 2023, por edhe më poshtë së treguesit shumëvjeçar. Veçanërisht pjesa e II e vitit 2024, rezultoi më e vështirë. Në këto kushte Shoqëria, u desh të menaxhojë situatën hidrike dhe treguesit e tjerë të operimit në mënyrë efikase. Kjo u arrit nëpërmjet kombinimit të parashikimeve hidro-meteorologjike të sakta dhe planeve të operim/shfrytëzimit efçente dhe të balancuara. Korporata administroi, operoi dhe shfrytëzoi kapacitetet hidrike në mënyrë mjaft racionale, për të prodhuar maksimumin e mundshëm të energjisë, dhe njëkohësisht për të ruajtur prametrat optimal të niveleve të shfrytëzimit dhe rezervës energjitike. Po kështu, në funksion të rritjes së gjenerimit dhe volumeve enegjitike, kontribuan Solar Karavasta por edhe asetet termike lundrues, duke amortizuar disi ekspozimin ndaj importit dhe optimizuar profilin e prodhimit të brendshëm, veçanërisht në pjesën e thatë të vitit.
- Gjatë vitit 2024, Programi Ekonomiko-Financiar i Korporatës u hartua me fokus në aktivitetin kryesor të përmbushjes sasiore të DSHP, pra në tregun e rregulluar. Si rezultat i parametrave jo optimal hidrik të faktuara gjatë periudhës, objektivat dhe planet operative vjetore, u rikalibruan dy herë gjatë vitit, nëpërmjet dy rishikimeve të PEF të Korporatës, duke ridimensionuar në kushtet e reja si aktivitetin e operacioneve të vijueshëm por edhe aktivitetin investues. Shpenzimet e përgjithshme operacionale u parashikuan të matura, sipas principeve të optimizimit dhe efçencës së kostove. Në lidhje me investimet, u planifikuan sipas objektivave kryesor si siguria e aseteve gjeneruese, rritja e efçencës në prodhim, shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese dhe infrastruktura e TIK. Për tu veçuar ishte fillimi i investimit për rikonstruksionin e rrugës Qafë Qelë-Koman me impakt të gjithanshëm jo vetëm por lidhjen ndërmjet HEC Koman dhe HEC ViD, por edhe me impakt të zhvillimit ekonomik-turistik të zonës përgjatë rrjedhës së Drinit dhe, si aks lidhës infrastrukture drejt zonës turistike të Alpeve.
- Aktiviteti tregtar gjatë 2024, u orientua ndaj sigurimit të sasive të energjisë për plotësimin e DSHP-së (tregu i rregulluar), si prioritet kryesor dhe të parashikuara në kuadrin ligjor/rregullator dhe me objektiv ekspozimin sa më minimal të mundshëm ndaj importit të energjisë (për sa është e mundur në një vit të thatë hidrik). Pavarësisht kufizimeve në volume disponibël energjie, u mundësuan në aktivitete të kënaqshme komerciale në pikat e forta të aktivitetit energjistik si shitjet në shërbimet ndihmëse/balancimit, kapacitete rezervë, optimizimi ekonomik i volumeve, shkëmbimi i energjisë në funksion krijimin e të ardhurave komerciale shtesë.
- Në rrafshin operativo-ekonomik, viti 2024 rezultoi me humbje, duke regjistruar një rezultat humbje neto të moderuar dhe sigurisht në kontrast me vitin e suksesshëm 2023. Pavarësisht parashikimit fillestar për një rezultat pozitiv të moderuar, situata e vështirë hidrike nuk mundësoi një rezultat pozitiv, por gjithsesi ai rezultoi më i mirë se PEF i Rishikuar II, i cili parashikonte një rezultat më negativ. Ecuria e operacioneve të vijueshme e 2024, tregoi në mënyrë të përsëritur se portofoli gjenerues aktiv pothuajse 100% hidro, shfaq varësi pothuajse të plotë të aktivitetit operacional të Shoqërisë ndaj kushteve hidro-meteorologjike. Për aq kohë sa ky ekspozim ndaj riskut hidrik do të jetë i lartë, ndikimi i tij do të jetë i ndjeshëm në qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë rezultateve ekonomike pozitive dhe stabilitetin/konsolidimin financiar të Korporatës.

- Në aspektin e objektivit strategjik të shtimit të diversifikuar të kapaciteteve gjeneruese, pas fillimit operimit në 2022 të impiantit PV diga Qyrfaq/HEC ViD me fuqi 5.14 MW, si kapaciteti i parë i diversifikuar i energjisë, që iu shtua aseteve gjeneruese të Korporatës, viti 2024, shënoi ecuri të kënaqshme në hapat zhvillimore të BRE si impianti PV Lundruës/ViD, PV Diga e Zadejës/ViD, PV Belsh dhe Projekti HEC Skavica.
- Në lidhje me liberalizimin e modelit të tregut të energjisë dhe reformave sektoriale, viti 2024 shënoi hapa edhe më të thellë në këtë drejtim. Gjatë vitit 2024, ALPEX filloi tregtimin si NEMO në dimension rajonal duke përfshirë në operimin e saj edhe tregun e energjisë të Kosovës. Pra tashmë tregjet e energjisë të Shqipërisë dhe Kosovës janë të unifikuar në ALPEX. Gjithashtu, nga Dhjetor 2024, ALPEX çeli live edhe aktivitetin e shit-blerjes së energjisë për profilin e tregtimit IDM (Intra-Day Market). Ky hap mjaft i rëndësishëm ridimensionon modelin shqiptar të tregut të energjisë, në nivele dhe standarte operimi nga më bashkëkohorët, duke integruar më ngushtë tregun e organizuar të energjisë nga ALPEX me tregun evropian të energjisë. Një zhvillim tjetër mjaft i rëndësishëm gjatë 2024 drejt liberalizimit të sektorit ishte edhe dalja në treg të lirë e konsumatorëve të lidhur në nivel tensioni 20 kV prej 1 Janar 2024. Ky zhvillim ka impakt pozitiv në aktivitetin komercial të Korporatës, pasi dalja e këtij segmenti lehtëson KESH nga një pjesë furnizimi për DSHP, duke lënë në dispozicion më shumë sasi të lirë energjie për tregtim, duke u fokusuar në kapjen e sinjaleve të tregut për çmime atraktive, me objektiv maksimizimin e të ardhurave të Shoqërisë.

Viti 2025 e gjen sektorin dhe tregun elektroenergjitik në transformim të mëtejshëm dhe me hapa të shpejtë reformues-liberalizues, pasi:

- Prej datës 1 Janar 2025, konsumatorët e lidhur në nivel tensioni 10 kV dalin në treg të lirë, duke dhënë efekt të dyfishtë pozitiv në aktivitetin komercial të Korporatës, pasi lehtëson Korporatën për ulje të mëtejshme të DSHP. Për më tepër, liberalizimi i tregut për fashën e tensionit 10 kV, krijon oportunitet të shtuar biznesi (duke shfrytëzuar licencën për furnizimin me pakicë) për ofrimin e furnizimit me pakicë/retail nga KESH, ndaj këtij segmenti konsumatorësh.
- Pas 1 Shkurt 2025, si rezultat i ecuresë pozitive financiare të sektorit veçanërisht OSHEE/FSHU dhe KESH dhe perspektivën pozitive të sektorit, çmimi për konsumatorët “Familjarë” nga 9.5 ALL/kWh (pa TVSH), në 8.5 ALL/kWh (pa TVSH), për konsumin mujor deri në 700 kWh. Ndërsa për konsumin mujor mbi 700 kWh, çmimi të mbetet i pandryshuar, pra 9.5 ALL/kWh (pa TVSH). KESH ka kontribuar direkt në marzhin e uljes së çmimit, pasi tashmë KESH do t’ja shesë FSHU energjinë për DSHP, me çmim më të ulët nga 2.6 ALL/kWh (pa TVSH), në 2.34 ALL/kWh (pa TVSH).
- Në aspektin hidrik, viti 2025, nuk ka nisur kënaqshëm, duke konfiguruar një start sfidues dhe me ekspozim ndaj importit. Duke shpresuar në një përmirësim hidrologjik të situatës, angazhimi i strukturave të Korporatës ka qenë dhe do të jetë maksimal në përmbushjen e objektivave të planifikuara në PEF 2025 (2026-2029).
- Në aspektin ndërkombëtar ecuria e tregjeve të energjisë në tërësi dhe të asaj elektrike në veçanti, do të vazhdojë të jetë e varur, e ndjeshme dhe derivat i situatave gjeopolitike veçanërisht konflikti Rusi-Ukrainë dhe Lindja e Mesme, me vështrimin për vendosjen e një paqe afatgjatë, e cila do të ndikojë në qetësim të tregjeve. Kjo varësi gjeopolitike nga rajonet/tregjet e pasura me karburant fosil, do të mjaft e ndjeshme, për aq kohë sa do të zgjasë tranzicioni global i kapaciteteve gjeneruese drejt BRE. Konkretisht, indeksi mesatar base-load i HUPX për periudhën Janar-Shkurt 2025, ka shënuar mesataren 149.5 Eur/MWh duke vazhduar tendencën rritëse të çmimit të fundit të 2024. Ky tregues është mbi +1.9x më i lartë se i njëjti tregues Janar-Shkurt 2024 prej 77.54 Eur/MWh. Pra risku i ekspozimit nga çmimi i tregut/importit është rritur. Përsa i përket së ardhmes afatshkurtër, referuar të dhënave të HUDEX mbi kontratat derivative të së ardhmes, aktualisht parashikohet që indeksi baseload për periudhën 2025-2026 të jetë më së shumti brenda fashës 85-100 Eur/MWh, duke projektuar fashë të ngritur të çmimeve të energjisë, si rezultat i kuotimeve spot me amplituda të rritura. Edhe këto parashikime janë evazive, pasi situata delikate gjeopolitike është e paparashikueshme, por trendi shfaq një kurbë më rritëse të çmimeve.

Në përfundim, falë edhe vizionit të stafit drejtues për zhvillimin e qëndrueshëm të Korporatës dhe mbështetjes së madhe të Qeverisë Shqiptare, objektivat e KESH sh.a. si prodhuesi më i madh dhe me përgjegjësi publike, mbeten të fokusuar në këto drejtime:

1. Garantimin e furnizimit për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik, sipas kuadrit ligjor dhe rregullator;
2. Rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të veprave të mëdha energjetike, në Kaskadën e Drinit nëpërmjet rinovimeve të vazhdueshme kapitale dhe modernizimit teknologjik;
3. Shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (kryesisht PV, por jo vetëm), për diversifikimin e portofolit gjenerues nëpërmjet Burimeve të Rinovueshme të Energjisë. Kjo strategji zhvillimore jo vetëm do fillojë të ulë varësinë e prodhimit nga forma hidro, por kombinimi i të dyjave do të sillte optimizim të rezervës energjetike, nëpërmjet operimit hibrid të burimeve gjeneruese, me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga aktiviteti komercial;
4. Komercializimi i mëtejshëm i aktivitetit ekonomik, nëpërmjet sjelljes proaktive, pjesëmarrëse në treg, shtrirja e mëtejshme të nivelin rajonal, si dhe modernizimit/digjitalizimit të procedurave të tregtimit të energjisë elektrike;
5. Transformimi i vazhdueshëm i Korporatës drejt qasjes adekuate ndaj tregut në transformim drejt liberalizimit, nëpërmjet orientimit të burimeve njerëzore drejt metodave dhe stilit të punës në skuadër, rritjes së performancës/produktivitetit dhe qasja drejt praktikave më bashkëkohore të zhvillimit të biznesit dhe teknologjisë/digjitalizimit.